



# UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | prill 2014

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

**BIBLIOTEKA E UBT-së  
PASUROHET ME 25 MIJË  
LIBRA SHKENCORË,  
PRITEN EDHE  
50 MIJË TË TJERË**



Faqe 3

**UBT BASHKËPUNON  
ME UNIVERSITETE  
GJERMANE**



Faqe 9



**STUDENTËT NGA  
UNIVERSITETI I  
OSLOS ZGJODHËN  
PËR VIZITË UBT-në**

Faqe 11

**TË PUNOSH NË UBT  
ËSHTË PRIVILEGJ  
DHE KËNAQËSI**

Faqe 13

**ARSYET QË KENIA  
UDHËHEQ NË BOTË  
ME TRANSFERIM  
PARASH PËRMES  
TELEFONAVE MOBILË**

Faqe 14

## KONFERENCA SHKENCORE E STUDIUESVE TË RINJ TË UBT-së



UBT në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Fakultetet, stafin akademik dhe ekspert të shumtë, ka organizuar aktivitetin e tij tradicional "Konferencën shkencore të studiuesve të rinj". Punimet e këtij aktiviteti janë zhvilluar në objektin e UBT-së, në Prishtinë, përgjatë gjithë muajit shkurt.

Faqe 6-7

## PROF. ZHILBERT TAFI: STUDENTËT E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE NË UBT KONKURRENTË NË BOTË

"Sidomos në pikëpamje të aftësisimit profesional studentët e Shkencave Kompjuterike në UBT, i kanë të gjitha kushtet që të jenë plotësisht konkurrentë me studentët e universiteteve tjera me renome në regjion dhe botë. Në laboratorët e UBT-së ata i kanë të gjitha kushtet për të krijuar një bazë të mirë që mundëson adaptim të shpejtë në tregun ekzistues dhe perceptim të lehtë të koncepteve të reja të teknologjive të së ardhmes", thekson Tafi.

Faqe 8





## Editorial



**Edmond Hajrizi**  
President i UBT-së

## PARA 5 VITESH...

Të nderuar lexues,

Qysh nga fillimi i punës së UBT-së, ne kishim një vizion që rezultatet dhe aktivitetet e stafit dhe të studentëve të UBT-së të paraqiten në një gazetë të botuar nga studentët e UBT-së, siç e kanë të gjitha universitetet në botë. Në çdo universitet të botës që vizitoja, shikoja me lakmi gazetë të tyre: përmbajtjen, disenjin, vëllimin. Pyetja ishte kur do të fillojmë edhe ne?

Kështu që edhe ne, para pesë vitesh, vendosëm ta botojmë gazetën e studenteve, të cilën e emëruam "UBT NEWS". Vendosëm që gazeta të botohet katër herë në vit, dy herë në semestër. Dhe kjo u bë realitet. Mund të them se forca kryesore që gazeta të dalë sa më shpejt ishte dhe mbetet Naile Demiri, përgjegjëse për Marrëdhënie me Publikun dhe kryeredaktore e kësaj gazete. Ajo mundësonte gjenerimin e lajmeve dhe raporteve, me çka krijohet brumi i gazetës. Një kontribut të konsiderueshëm ka dhënë edhe kolegu ynë Safet Zejnullahu, i cili si redaktor disa vjeçar në gazetën ditore "Zëri" tani kontribuonte me këshillat e veta profesionale, por edhe me redaktim gjuhësor.

Sot ...

"UBT NEWS" e ka marrë formën dhe përmbajten e vet dhe me padurim presim të dalë numri i radhës. Duke marrëparasysh se tani kemi edhe Fakultetin për Media dhe Komunikim, është arritur që të involvohen studentët por edhe stafi akademik i Mediave dhe Komunikimit, që punojnë për të avancuar përmbajtjen dhe cilësinë profesionale të kësaj gazete. Po punohet që gazeta të botohet çdo muaj. Përveç gazetës, po punohet që UBT të ketë edhe produktet tjera mediale (portalin, radion, televizionin dhe mediat e tjera sociale, të cilat po rriten dhe po shtohen çdo ditë), të cilat, përveç që u mundësojnë studentëve të realizojnë ushtrimet e tyre profesionale, po ashtu edhe mundësojnë të prezantohen rezultatet e tyre dhe të stafit, duke krijuar njëkohësisht edhe një forum të debatoje përçështjet me rëndësi për vendin dhe shoqërinë. Infrastruktura e re dhe investimet në laboratorët përkatës medial po krijojnë një ambient shumë të përshtatshëm për këtë drejtim.

### Vizioni po bëhet realitet

Me këtë rast kemi kërkuar që edhe dekani, prof. Belul Beqaj, ta shkruajë një editorial, të cilin mund ta gjeni në vazhdim.

**Urime 5-vjetori "UBT News" dhe suksese edhe më tutje!**

*Presidenti i UBT-së,  
Edmond Hajrizi*

## MADHËSHTIA E JUBILEUT TË VOGËL

Dr. Belul BEQAJ

Ia nisëm gazetës "UBT NEWS"-it, me dëshirë të madhe dhe mundësi të vogla para pesë viteve. Menduam që UBT-ja ta ketë një dritare të hapur për ata që janë pjesë e saj, por edhe për ata që dëshirojnë të bëhen apo të informohen për të gjitha çështjet e rëndësishme akademike shkencore dhe intelektuale. Kështu punuam rreth katër vjet. Vitin e kaluar, pas disa përpjekjeve, është akredituar edhe Fakulteti i Mediave dhe Komunikimit dhe gazeta jonë ka marrë krahë për të realizuar shumë synime të cilat fillimisht ishin vështirë të arritshme. Mundësitë e shtuara shtuan edhe vizionet e objektivat tona. Para së gjithash, ne jemi në rrugë të mirë që gazetën studentore të mos e bëjmë nga të stafit akademik por studentë që hapat e parë të gazetarisë po i mësojnë në gazetën e tyre. Por, synimet janë në rritje, meqë së shpejti presim fillimin e punës së portalit, radios, studios së televizionit, institutit dhe revistës politike profesionale që po e përgatisim nga fusha e Shkencave Politike. Pra, sot, në pesëvjetorin e kësaj gazete, jemi shumë më të aftësuar dhe profesionalisht më të përgatitur që gazeta jonë të jetë vlerë e shtuar në ambientin medialjo vetëm të institucioneve të larta shkollore por edhe të mjedisit profesional medial.

Sot, nuk do të përkujtojmë aq shumë të kaluarën e kësaj gazete, sa jemi të preokupuar me nevojën

e mobilizimit të përgjithshëm që "UBT NEWS" të bëhet strumbullar dhe fokus i informacioneve dhe njohurive për të gjitha zhvillimet brenda këtij institucione dhe të gjitha zhvillime jashtë tij, që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve informative, të cilat këtë institucion e bëjnë më të afërt me studentët dhe të gjithë të interesuarit për të. Vizionii "UBT NEWS" ka për qëllim përfshirjen sa më të madhe të studentëve, stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve në afirmimin e punës së tyre dhe të institucionit. Konsiderojmë se përgjegjësia publike nuk është vetëm e atyre që e kanë profesion gazetarinë, por edhe angazhimin akademik dhe intelektual. Ndërsa, misioni ynë është që të kontribuojmë në zgjerimin e bashkëpunimit, tolerancës dhe përfirimit të të gjithëve që, në baza të shëndosha, angazhohen për ngritjen e përgjegjësisë intelektuale.

Fundja, nuk dëshirojmë që të na realizohen të gjitha dëshirat në të ardhmen, meqë atëherë nuk do të kemi dëshira, as të gjitha pritjet, meqë atëherë nuk do të kishim pritje të tjera. Dëshirojmë që të gjithë të mblidhemi rreth këtij fanari informativ për aq sa do të na bëjë të lumtur si pjesë e shtëpisë së madhe intelektuale, akademike dhe shkencore. UBT-ja po hapëron drejt dhe sigurt me të gjithë ata studentë që kanë "Zgjedhur më të mirin", ngase, me plot arsye, dëshirojnë të bëhen më të mirë. UBT-ja është vendi dhe rruga e duhur për t'u bërë në jetë më i rëndësishëm. Në këtë kuptim "UBT NEWS" vetëm sa do të shndrit rrugën e ardhmes që ka filluar para 13 vjetëve.



**13 YEARS**  
**LEADERSHIP and INNOVATION**

Education • Research • Training • Consulting  
2001/2014

### IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

**Botues:** Edmond Hajrizi

**Kryeredaktore:** Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT.

**Adresa:** www.ubt-uni.net | **Tel:** 038 541 400, 044 541 400

**Thyerja Grafike:** ELV Studio

**Shtypet në Shtypshkronjën «Roto Print»**



**UNIVERSITY EDUCATION  
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**

**AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY**



# UBT AFTËSON LIDERËT E SË ARDHMES



PRISHTINË, 13 JANAR 2014

Me qëllim të aftësimit praktik, grupi i bashkuar i studentëve të vitit të parë të Fakultetit të Shkencave Politike në UBT mori pjesë në një aktivitet tre ditor me qëllim të përvetësimit të procedurave legjislativë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ditën e parë, studentët vizituan Kuvendin, u njoftuan me ambientet e brendshme, dhe ndoqën një ligjërime të shkurtër rreth procesit ligjvënës dhe strukturës e hierarkisë së brendshme në Kuvend.

Ditën e shtunë, puna u nda në dy pjesë. Së pari, studentët ndoqën një ligjërime rreth debatit politik dhe ideologjive kryesore të shekujve të fundit. Pas ligjërimit, studentët simuluan formimin e partive dhe filluan të hartojnë programet e tyre politike. U krijuan gjithsej shtatë parti nga i gjithë spektri politik, përfshirë edhe një parti të minoriteteve. Pas negociatave paraprake për koalicionet për ditën e nesërme, u zgjodhën edhe përfaqësuesit e partive në pozicionet më të rëndësishme – kryetarët e grupeve parlamentare, anëtarët dhe

kryetarja e komisionit funksional, si dhe kryetarja e kuvendit. Së fundi, u zhvilluan edhe bisedime rreth qëndrimeve të partive të ndryshme lidhur me ligjin i cili do të diskutohej ditën e nesërme.

Ditën e diele u zhvillua simulimi i një seance të rregullt plenare të Kuvendit të Kosovës. Fillimisht, koalicioni i Partisë Liberale me atë Konservatore propozoi ligjin për tatimin mbi të ardhurat personale, me disa ndryshime për të cilat kishin rënë dakord më parë dy partitë. Më pas, u hap diskutimi edhe për deputetët e partive të tjera,

të cilët përmes fjalimeve dhe pyetje-përgjigjeve dhanë sugjerime për disa amendamente. Këto amendamente u diskutuan më pas në një seancë të veçantë nga komisioni, i cili doli me një version të përmbledhur që e propozoi për miratim. Në votimin përfundimtar, ligji i propozuar nga komisioni kaloi me shumicë votash.

Gjatë këtij trajnimit të shkurtër, studentët jo vetëm që morën njohuri rreth punimeve të Kuvendit, por edhe i vunë këto njohuri në përdorim, duke marrë, të paktën për një fundjavë, rolin e një poli-

tikani dhe deputeti të Kuvendit të Kosovës. Gjatë vitit akademik, kemi planifikuar të organizojmë simulime të ngjashme edhe për hallkat e tjera të pushtetit: ekzekutiv dhe gjyqësor, në bashkëpunim me Fakultetin e Juridikut dhe Fakultetin e Medias dhe Komunikimit. Nisur nga interesimi, vullneti, dhe rezultatet e treguara nga studentët, jemi në rrugë të mirë që nga UBT-ja të aftësojmë liderët e ardhmes që do të praktikojnë njohuritë e përfituara edhe rreth institucioneve të tjera më të rëndësishme politike në Kosovë.

PROFESORI PESHKOPIA FURNIZON BIBLIOTEKËN E UBT-SË ME TITUJ TË LIBRAVE NGA SHBA-JA

## BIBLIOTEKA E UBT-së PASUROHET ME 25 MIJË LIBRA SHKENCORË, PRITEN EDHE 50 MIJË TË TJERË

PRISHTINË, 20 JANAR 2014

UBT-ja në bashkëpunimi me stafin akademikë, në këtë rast me prof. dr. Ridvan Peshkopia, gjatë këtyre ditëve bibliotekën universitare, e ka furnizuar edhe me 25 mijë tituj të rinj të librave shkencorë, të ardhura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga të gjitha fushat që studiohen në UBT. Po ashtu, profesori Peshkopia, paralajmëron se kontingjenti tjetër me libra të tillë është në rrugëtim e sipër, po me shifrën e njëjtë, me 25 mijë libra.

**Shkëpusim një pjesë të intervistës së profesorit Peshkopia dhënë për gazetën "UBT News".**

**UBT News: Çfarë ju ka motivuar të bashkëpunoni me UBT-në me fokus të veçantë për bibliotekën, sjelljen e librave nga SHBA-ja?**

**Prof. Peshkopia:** Pas një përvojë akademike në disa universitete amerikane, unë u ktheva përkohësisht në Shqipëri dhe Kosovë (unë nuk i shikoj ato të ndara) për të qenë më pranë familjes time dhe për të kontribuar me aq sa mundesha për përmirësimin e standardeve akademike në vendin tonë. Qysh kur jam kthyer, kam dhënë mësim



edhe në dy universitete të tjera në Shqipëri e Kosovë, por rrethanat e sollën që të filloj me kohë të plotë në UBT dhe për këtë jam

shumë i lumtur. Në fakt, unë kam ndihmuar edhe dy universitetet ku kam punuar më parë, në pasurimin e bibliotekave të

tyre, por mbështetja që kam gjetur në UBT më ka frymëzuar për t'u përqendruar në krijimin e një biblioteke shumë të madhe universitare këtu. UBT-ja është shfaqur si një partner serioz në planet e mia, për të krijuar një bibliotekë universitare gjigante dhe fillimi ka qenë shumë i mbarë. Ne tashmë kemi filluar dhe 25 mijë librat e parë kanë ardhur nga SHBA-ja. Pas pak muajsh do të vijnë edhe 25 mijë të tjerë. Ndërkohë, në UBT po vazhdon puna për katalogimin e librave që sapo kanë mbërritur. Jam shumë i lumtur që UBT-ja po i përgjigjet me korrektësi këtij dinamizmi të punëve dhe kjo është mënyra më e mirë për të bashkëpunuar me partnerët tanë amerikanë.

**UBT News: Profesor, a mund të na jepni disa detaje rreth këtyre titujve si dhe për procesin e sjelljes së këtyre librave, që nga gjetja e tyre, dhe deri në finalizim?**

**Prof. Peshkopia:** Lajmi i mirë është se ky proces nuk do të finalizohet kurrë; ky është një proces i hapur dhe që nuk ka kufij kohorë. Për sa kohë shtypen libra të rinj, ne duhet të jemi në kërkim të pasurimit

të bibliotekës tonë. Por, tani për tani ne kemi disa objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm. Një objektiv afatshkurtër është sjellja brenda vitit 2014 edhe e 50 mijë librave të rinj. Kjo do ta plotësonte bibliotekën tonë si një nga bibliotekat universitare më të mëdha në Ballkan. Ne shpresojmë që ky ritëm të vazhdojë edhe për vitin në vazhdim. Por, ky projekt do të kulmojë kur UBT-ja të ndërtojë godinën e bibliotekës së re në kampusin e Lipjanit. UBT nuk mund të them se kur kjo do të ndodhë konkretisht, por e di që UBT-ja e ka këtë plan. Ne i gjejmë librat në universitete apo privatisht në SHBA, e të cilët janë të gatshëm t'i dhurojnë ata me bujari, cilitdo që paraqet seriozitet në vënie e tyre në përdorim. UBT-ja, me trupën e saj të mrekullueshme të studentëve, pedagogëve dhe kërkuesve ka treguar se jo vetëm ka nevojë për një bibliotekë të pasur universitare.

Që nga sot këta tituj janë të renditur në raftete kësaj Biblioteke, dhe mund të shfrytëzohen nga të gjithë të interesuarit.

*Intervistën realizuan Liridona Bytyqi, Fortesa Krasniqi dhe Valdrin Maloku*



## STUDENTËT E FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE NË UBT VIZITUAN KUVENDIN KOMUNAL NË FERIZAJ

PRISHTINË, 21 JANAR 2014

Bazuar në filozofinë mësimore të UBT-së, për ndërlidhje të pjesës teorike me atë praktike, sot studentët e Fakultetit të Shkencave Politike nga Ferizaj në UBT, në kuadër të lëndës Politikat e Qeverisjes Lokale, të shoqëruar nga prof. dr. Ibrahim Krasniqi, vizituan Kuvendin Komunal në Ferizaj.

Gjatë vizitës ata u pritën në sallën e Kuvendit nga Kryesuesi i Kuvendit z. Milazim Haliti, i cili njoftoi studentët për funksionet dhe detyrat e Kuvendit, punën dhe sfidat si dhe politikat qeverisëse vendore në Ferizaj. Në këtë takim mori pjesë edhe drejtori i Administratës së Përgjithshme të Komunës së Ferizajt z. Naim Ferati, i cili gjatë vizitës së studentëve pastaj në objektet e qeverise komunale i njoftoi ata me angazhimet e tyre drejt realizimit të kërkesave të qytetareve dhe përmirësimit të kushteve të jetës për ta. Studentët parashtruan shumë pyetje dhe u interesuan për formulimin e politikave zhvillimore komunale, ndërtimin e ekzekutivit dhe ndikimin politik në të, për mundësitë e përmirësimit të shërbimeve dhe shumë çështje tjera relevante për nivelin.



## UBT PJESË E TAKIMIT TË AKREDITIMIT TË AKA-SË NGA ENQA



PRISHTINË, 22 JANAR 2014

Gjatë aktiviteteve të përditshme dhe të pandalshme UBT ka qenë pjesë edhe e takimit të akreditimit të Agjencisë së Akreditimit të Republikës së Kosovës AKA-së nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Në këtë takim të akreditimit, kanë qenë të ftuara tri universitete publike dhe dy private, ndër privatët UBT.

Takimi është zhvilluar në katër nivele, ku përfaqësuesit e UBT-së, ishin si, nivelin e rektorëve e ka përfaqësuar rektor i këtij institucioni, prof. dr. Edmond Hajrizi, Zyrën e Cilësisë, can. dr. Lulzim Beqiri, të mësimdhënësve can. dr. Fatbardha Qehaja- Osmani, dhe nivelin e fundit, të studentëve, Lirigzona Morina.



## AMBASADORI I GREQISË NË PRISHTINË, z. MOSKOPOULOSU LIGJËROI STUDENTËVE TË UBT-SË

PRISHTINË, 22 JANAR 2014

Me ligjëratën e radhës para studentëve të UBT, u paraqit ambasadori i Greqisë në Prishtinë, Dimitris Moskopou-

los, me temën rreth qëndrimit zyrtar grek në negociatat rreth emrit të ish RFJ të Republikës së Maqedonisë.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e amba-

sadorit Moskopoulos, ata përfituan njohuri të reja nga fusha për temën të cilën ligjëroi.

Ligjëratat përveç studentëve dhe profesorëve u përcjell edhe nga shumë të interesuarit tjerë.

## UBT-JA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHKÇAK



PRISHTINË, 27 JANAR 2014

Me qëllim të zhvillimit të programeve të përbashkëta, shkëmbimin akademik dhe certifikime, në ambientet e UBT, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndërinstitucional në mes të UBT-së dhe Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, (SHKÇAK).

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, në mes të këtyre dy institucioneve, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga Drejtori i Financave, prof. Selman Berisha, së bashku me delegacionin e Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, në përbërje të të cilit ishin, Kryetari i Këshillit të SHKÇAK, Fahri Breznica, Drejtoresha Ekzekutive, Ardiana Bunjaku dhe Edona Perjuci - Uka, Arbër Hoti, Art Navakazi, etj, para profesorëve dhe studentëve të UBT-së prezantuan marrëveshjen e nënshkruar.

"UBT dhe SHKÇAK pajtohen që të zhvillojnë programe bashkëpunimi, shkëmbimi akademik

dhe certifikime, shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapësirave që studentët e UBT-së të realizojnë Certifikimin Teknik të Kontabilitetit në SHKÇAK", ka theksuar presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi.

Ndërkaq delegacioni i SHKÇAK, para të pranishmëve është shprehur i kënaqur me të arriturat e UBT-së, me theks të veçantë programet e studimit nga fusha e ekonomisë, me teknologjinë më moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arritjet e studentëve. Bashkëpunimi ndërinstitucional në mes UBT dhe SHKÇAK, ka filluar më herët nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme për shkëmbim të studentëve dhe stafit.

Kryetari i Këshillit të SHKÇAK, Fahri Breznica, përveç tjerave të pranishmit i ka njoftuar edhe me objektivat zhvillimore dhe aktivitetet vepruese që ky institucion do t'i ketë në periudhën vijuese konform planit të tyre.

## EROLL BILIBANI U LIGJËROI STUDENTËVE TË UBT-SË

PRISHTINË, 16 JANAR 2014

Me ligjëratën e radhës para studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompiuterike në UBT, u paraqit drejtori i "Dokufestit" në Prizren, Eroll Bili-

bani, me temën "Starting small- fetting big", në kuadër të lëndës Gjuhë Angleze, ligjëruesja mr. Edita Alo.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e ligjëruesit

në fjalë, ata përfituan njohuri të reja nga fusha për temën të cilën ligjëroi.

Ligjëratat përveç studentëve dhe profesorëve u përcjell edhe nga shumë të interesuarit tjerë.





## STIKK: UBT VLERËSOHET MË I MIRI NË VEND

PRISHTINË, 13 SHKURT 2014

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, së bashku me një grup profesorësh, mori pjesë në takimin e organizuar nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), ku u prezantua raporti mbi "Analizën e mangësisë së shkathtësive në TIK", si dhe "Analizimin e tregut të ICT në Kosovë".

Gjatë këtyre dy hulumtimeve janë intervistuar një numër i caktuar i kompanive të ICT-së, duke u munduar të identifikojnë

studentët që dalin nga institucionet arsimore se a janë të gatshëm për punë, dhe me cilët studentë janë më të kënaqur dhe anasjelltas.

Në raportin mbi "Mangësinë e Shkathtësive në Sektorin e TIK-ut, UBT vlerësohet si Institucion i Arsimit të Lartë më i miri në vend, që kontribuon në edukimin e brezave të reja në këtë fushë, duke ju ofruar kompanive e institucioneve, si atyre publike e po ashtu edhe atyre private, studentë kualitativ të përgatitur për vende të punës. "Është këna-

qësi e veçantë të dëgjohet se UBT është i vetmi Institucion i Lartë Arsimor, që brenda vitit regjistrohet më shumë se 600 studentë vetëm në fushën e ICT, prej të cilëve mbi 80% e tyre vijnë nga shkollat e mesme si nxënës të shkëlqyer", u shpreh presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Në hulumtim përveç pyetjeve tjera ishte edhe ajo se sa është numri i studentëve të regjistruar në Institucionet e Arsimit të Lartë brenda një viti të caktuar, nga që UBT-ja del të jetë lidere me numrin më të lartë si në

nivelin Bachelor ashtu edhe në nivelin Master për ICT. Ndërsa, në pyetjen se nga cilat institucione arsimore vijnë punonjësit me të cilët kompanitë ndahen të pakënaqura, në këtë rast Ju informojmë se UBT nuk bënë pjesë në këtë listë. Kjo na bënë të ndihemi krenar për kualitetin e studentëve tanë, të cilët në vendin e tyre të punës dalin të jenë të përgatitur në nivelin më të lartë, si për nga dituria ashtu edhe për nga shkathtësitë e tjera shoqërore, thuhet në raportin e publikuar nga STIKK.



## ME RASTIN E DITËS SË PAVARËSISË, ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI MBAJT LIGJËRATË NË UBT

PRISHTINË, 15 SHKURT 2014

Me rastin e 6Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi, sot mbajti një ligjëratë para studentëve dhe stafit akademik të UBT në Prishtinë.

Ai u prit nga presidentii UBT-së, prof. dr. Edmon Hajrizi dhe dekani i Fakultetit të Mediave dhe Komunikimit, prof. dr. BelulBeqaj.

Në fjalën hyrëse presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, falënderoi zëvendëskryeministrin Kuçi për vizitën e tij dhe shtoi se për UBT-në është nderë që me rastin e 6 vjetorit të shtetësisë së Kosovës të mbahet një ligjëratë nga njeriu i cili ka qenë pjesëmarrës i pothuajse të gjitha zhvillimeve të rëndësishme të Kosovës.

"Kosova ka filluar të njihet edhe ndërkombëtarisht edhe në aspektet profesionale akademike. Sot, Kosova është anëtare e asambleve të ndryshme akademike e shkencore si shtet në vete, po ashtu së fundmi edhe në rrafshin sportiv dhe këto janë hapa shumë pozitiv dhe na bënë edhe më shumë krenar që së bashku ta festojmë këtë 6 vjetor të pavarësisë së Republikës së Kosovës", tha presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmon Hajrizi.

Në ligjëratën e tij, zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi, u përqendruar në 3 procese, në atë të çlirimit të Kosovës, në procesin e krijimit të shtetit dhe në të ardhmen, atë që Kosovën e pret drejt integritetit evropian.



Sipas, zëvendëskryeministrin Kuçi, në të gjitha proceset deri më sot Kosova ka qenë e koordinuar mirë me faktorin ndërkombëtar dhe ky fakt siç tha ai, ka rezultuar në të arriturat e deritanishme.

"Procesi i shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran erdhi si pasojë e një dialogu të gjatë në Vjenë, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pala serbe nuk pranoi që të arrihet një marrëveshje, prandaj ne, në koordinim të plotë me vendet mike të Kosovës, morëm

vendim për ta shpallur shtetin e Kosovës. Për datën e përafërt të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ne, institucionet e vendit e kemi ditur qysh në dhjetor të vitit 2007. Kanë qenë dy data të propozuara, 17 shkurti pasdite dhe 18 shkurti paradite. Nuk ka qenë e lehtë të vendoset saktësisht pasi ka pasur rrezik të eskalimit të situatës së sigurisë, si për shembull reagimet në veri dhe një largim masiv i komunitetit serb nga Kosova. Këto kanë qenë dilemat tona, pasi nuk

kemi dashur që problemet tjera ta minimizojnë shpalljen e pavarësisë në aspektin medial, siç do të ishte një eksod eventual i serbëve", tha zëvendëskryeministri Kuçi.

Megjithëse sipas tij, për datën dhe gjithë organizimin e asaj dite historike ka ekzistuar një koordinim i përkryer me bashkësinë ndërkombëtare, në veçanti me miqtë e Kosovës.

Duke folur për periudhën e pas shpalljes së pavarësisë ai përmendi 106 njohjet e shtetësisë së Kosovës dhe procesin e bisedimeve me Serbinë në Bruksel. Kuçi tha se, ky proces nuk është i lehtë por me ndërmjetësimin e BE-së me 19 prill të vitit të kaluar u nënshkrua një marrëveshje që shumë pak e kanë pritur të ndodhte në mes Prishtinës dhe Beogradit. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, tha se, bisedimet, edhe pse të vështira, janë të domosdoshme për të arritur të një paqe e qëndrueshmëni këtë rajon dhe janë hap determinues drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

"Nuk mund të flasim për një datë të saktë të integritetit të Kosovës në BE, por për mua viti 2020

është një kohë e përshtatshme e përfundimit të procesit integruar të shteteve në familjen evropiane", tha Kuçi.

Ai theksoi se është i sigurt që bisedimet me Serbinë do të përfundojnë me nënshkrimin e një Traktati të Miqësisë mes dy shteteve të pranuar reciprokisht.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, tha se, Kosova nuk e ka të lehtë të bëhet anëtare e OKB-së, pasi për këtë gjë nuk ka pajtueshmëri nga Rusia.

"Ne duhet të jemi real kur flasim për anëtarësim në OKB. Një shtet i vogël siç jemi ne nuk mund ta bindim një vend si Rusia, por këtë duhet bëjmë duke kërkuar ndihmën e miqve", tha Kuçi.

Ai tha se, puna e madhe është kryer, ndërsa u mbetet gjeneratave të ardhshme, studentëve në veçanti, që ta krijojnë atë që ai e quajti "ADN" e shtetit.

Të pranishmit, nga stafi akademik dhe studentët patën mundësinë që zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi, t'i drejtojnë pyetje në çështje kryesisht politike që kanë të bëjnë forcimit të institucioneve të Republikës së Kosovës.





# KONFERENCA E STUDIUESVE TË

UBT në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Fakultetet, stafin akademik dhe ekspert të shumtë, ka organizuar aktivitetin e tij tradicional "Konferencën shkencoretë studiuësve të rinj". Punimet e këtij aktiviteti janë zhvilluar në objektin e UBT-së, në Prishtinë, përgjatë gjithë muajit shkurt.

*T'i ndjekim si mëposhtë:*

## "Ditët e Ndërmarrësisë"

Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, me punime të tyre janë paraqitur një numër i madh i studentëve UBT-së, që kanë prezantuar planet dhe idetë e tyre të biznesit.

Komisioni i përbërë nga disa profesorë të lëndëve përkatëse të UBT-së, dhe mbikëqyrës të punimeve, u shpreh ientuziazmuar për rezultatet e studentëve dhe dhanë përshtypje pozitive të biznes planeve. Ata ishin pozitivisht të befapsuar me cilësinë dhe përkushtimin e shfaqur nga ana e studentëve. Komisioni në fjalë tha se gjatë procesit të mentorimit, kanë vënë re se studentët me kalimin e kohës janë lidhur me idetë e tyre biznesore dhe do të jenë në kërkim të mundësive financiare për hapjen e tyre.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, tha seky aktivitetet është pjesë e planit tradicional dhe strategjik të UBT-së, për t'i plotësuar studimet tona më bashkëkohore. Ai me tej shtoi seobjektiv i kësaj dite është që të promovohet sa më shumë ndërmarrësia, të shihet roli dhe rëndësia e saj, të vlerësohen idetë e studentëve, të arrihet një pjekuri e kompetencës së tyre në të bërit biznes. Ai shtoi se UBTka menduar qëstudentëve, autorë të planeve biznesore të përzgjedhura t'iu ndihmojë për ta nisur një biznes të ri.

Ndërsa Armend Muja, profesor në UBT dhe vlerësues i këtyre punimeve të aktivitetit në fjalë, thase

rëndësia e biznes planeve konsiston në aspektin empirik të punës dhe studimit të studentëve. "Biznes planet janë forma më e mirë e projektimit të ideve biznesore të studentëve përpara se të inkudrohen në tregun e punës. Në realitet lënda ka shërbyer edhe si lloj inkubatori biznesor meqë bartësit e lëndës kanë punuar në disa faza me studentët - në procesin e selektimit dhe strukturimit të idesë biznesore, në analizën e tregut, në planin e marketingut, planin operacional dhe financiar. Gjithashtu studentët patën rastin që të kenë ballafaqimin e parë me dimensionin praktik të studimit por edhe kanë përfituar edhe përmes ekspozimit në trendët dhe mjetet bashkëkohore të analizës së ambientit biznesor dhe faktorët rrethor që ndikojnë avancimin e idesë së tyre biznesore.

Planet e biznesit të prezantuar itakojnë disa fushave si agrobiznesit, industria e përpunimit të ushqimit, riciklimi dhe përpunimi i metaleve, industria e shërbimeve dhe ato të sferës së ICT-së.

Me prezantimin e punimeve janë si: Lum Gashi, Margona Metaj, Yllka Abdullahu, Alma Feka, Leotrim Xhemshiti, Frosina Islami, Kushtrim Limani, Emrolina Durriqi, Qendresa Stublla, Fitore Murati, Fatos Sejda, Afrim Bajraktari, Fatos Nura, Besim Rama, Andrra Sylq, Jeta Belallari, Fllanza Binaj, Sumeja Zhilivoda, Petrit Dunnica, Fiona Haxhiu, EdonaThaqi, Dea Mehmeti, Perparim Abazi, Florentina Bekteshi, Rrezarta Spanca, Pirro Piraj, Bislim Konjufca, Valmi-



ra Vranovci, Premtim Tmava, Agon Pruthi, Minator Pozhegu, Arber Mekaj, Gent Gacaferri, Shkelqim Dragusha, Edisona Zeka, Albulena Popaj, Hekuran Popaj, Fatmir Prekupi, Egzon Rama, Dardan Tafarshiku, Valon Dragusha, Erblin Lubishtani, Arianit Haxha, Valon Bozhdaraj, Fatlum Arifi, Visar Luma, Imir Gashi, Florim Ilazi, Majlinda Basha, Ermira Gashi, Edon Fishekqiu, Shkelqim Sadiku, Laureta Miftari, Liridona Rama, Fatbardha Krasniqi, Leonida Gjergjaj, Donat Karaxha, Bleranda Musa, Platina Mahmutxhiku, Rita Shallici, Marigona Gashi, Larglinda Bilalli, Granit Bunjaku, Adrian Osmani, Artan Nalli, Bardhyl Hyseni, Oktaj Agushi, Bajram Statovci, Blerta Agushi, Rafet Veliu, Egzona Loshaj, Ardina Halidi, Flamur Kadriu, Dorentina Rexhepaj, Liridon Sinanaj, Fatlume Mustafa, Donika Bekteshi, Adriana Bunjaku, Besnik Gjyshinca, Nehat Hajrizi, Sabit Ferati, Elvedina Cana, Ardiana Latifi, Rinor Cena, Agon Neziri, Besarta Collaku, Besa Osmani, Shqipdona Haklaj, Leonora Sejdiqaj, Edona Gërbeshi, Alena Azari, Rrahman Krasniqi, Ardita Krasniqi, Egzon Shabani, Florentina Musliu, Vigan Bulliqi, Leutrim Shala, Albijona Gashi, Marigona Hargaja, Florentina Krasniqi, Petrit Kelmendi, Donika Lushaku, Drin Krasniqi, Dardan Rama, Rina Shamolli, Zana Topalli, Driton Zeka, Bardha Klinaku, Dielleza Krasniqi, Fjolla Krasniqi, Yllka Canolli, Lorika Latifi, Teuta Kastriati Shqiponje Junuzi, Halime Martinaj, Feliks Nikolla, Florije Puka, Ard Puka, Valjeta Babiqi, Arbnora Gashi, Loreta Nitaj, Jetmira Krasniqi, Gezim Sokoli, Granit Demolli, Baton Gashi, Ron Deri, Gresa Zogjani, Arbresha Qerkini, Dafina Aliu, Ismet Gosalci, Florina Mekuli-Bajraktari, Albert Hoxha, Petrit Mehmeti, Sherif

Gosalci, Blerim Hoxha, Bekim Rrahmani, Fjolle Rrustemaj, Jeton Kosumi, Lavdie Abazi, Dren Tigani, Shpat Hamiti, Fiona Zeqiri, Agron Selmani, Drin Kajtazi, Agon Gashi, Agrin Gashi, Agrin Krasniqi,

## Nga fusha e mediave dhe shkencave politike

Edhe studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim, dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Politike të UBT, organizuan këtë aktivitet. Punimet e Konferencës nga Fakulteti i Mediave dhe Komunikimit, u zhvilluan në tri sesione, në sesionin parë nga Gjuha dhe stilistika, në të dytin nga Zhanret e gazetarisë, me theks të veçantë prezantuan punime për reportazhin, dhe në sesionin e tretë për Historinë e gazetarisë. Poashtu edhe në Fakultetin e Shkencave Politike, u prezantuan dhe u diskutuan punime dhe ide të ndryshme të studentëve me tematikë teorike dhe filozofike, si ngritja e cilësisë së demokracisë së Kosovës, ashtu edhe konkrete e praktike, si analiza e zgjedhjeve të fundit lokale.

Përveç studentëve të këtij Fakulteti, morën pjesë edhe profesorë edhe mysafirë dhe ekspert të lëmive të ndryshme,

Duke folur para të pranishmëve si profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë dekani i dyja Fakulteteve të cekura si më lartë, prof. dr. Belul Beqaj tha: "Ju dëshirojmë mirëseardhje në këtë aktiviteteku qëllimi i saj ështënjë mundësi për studentët rinj që të shkëmbejnë ide dhe eksperienca në disiplina, tradita dhe perspektiva të ndryshme si dhe të ndërlihen me çështjen shkencore".

Ndërsa Musa Sabedini, profesor, tha se punimet e përzgjedhura të studentëve janë një dëshmi

e mirë se në UBT çmohet vlera dhe cilësia. Studentët e Mediave dhe Komunikimit në UBT e kanë mundësinë që në mënyrë profesionale dhe me sllajde të bëjnë prezantimet e tyre, një ngjarje kjo që nuk ndodhë në universitetet e tjera. Personalisht isha i kënaqur me punimet e studentëve të cilët u treguan të motivuar, u treguan të sinqertë dhe të përkushtuar që punimet e tyre t'i prezantojnë para kolegëve dhe profesorëve të tyre.

Po ashtu edhe profesoresha, GjylieRexha tha sepunimet e prezantuar në konferencën e sotme janë dëshmia më e mirë për cilësinë dhe përkushtimin e studentëve të Mediave dhe Komunikimit në UBT. Cilësia me të cilën u paraqitën studentët, është tregues i qartë për ndryshimin përmbytësor dhe cilësor, të cilën do ta sjellin në të ardhmen, në peizazhin mediatik, studentët e tanishëm të Mediave dhe Komunikimit në UBT".

"Kjo konferencë është një mundësi e mrekullueshme që UBT-ja ua ofron studentëve si pjesë e studimeve. Kjo është brenda konceptit modern të mësimnxënies, sipas të cilit studentët mësojnë më tepër duke praktikuar. Në këtë konferencë, studentët kanë ardhur pas disa fazash, duke filluar nga ideja, hulumtimi, realizimi dhe shkrimi i punimeve, për të përfunduar me prezantimin dhe përballjen me audiencën dhe kritikën, duke përfituar teje mase nga e gjithë kjo përvojë. Konsideroj, se jo vetëm konferenca, por i gjithë programi i Fakultetit të Mediave dhe Komunikimit është konceptuar si një ndërthurje e të gjitha elementeve të cilat e përbëjnë gazetarinë si profesion sot", Resul Sinani, profesor në UBT.

I gjithë grupi i studentëve prezantues, të të dyja Fakulteteve, edhe studentët tjerë u ndjenë privilegjuar meqë u ka dhënë mundësi të prezantojnë punime dhe të shprehin aftësitë e tyre në një ambient të mirëfillt shkencorë.

"Prezantimi ishte një mënyrë e mirë e paraqitjes së punimeve të studentëve, ku secili kishte mundësi të prezantohej para profesorëve dhe komisionit dhe të marrin mendimet të tyre rreth punimeve hulumtuës, dhe pas kësaj konference do të jemi edhe me të aftë për punime edhe konferenca tjera shkencore", tha studentja Erza Brahusi.





# SHKENCORE RINJ TË UBT-së

Ndërsa, Albina Zeneli, studente, tha pjesa që më pëlqeu më së shumti ishin debatet e shumta që tregonin interesim për ato punime.

*Me prezantimin e punimeve të të dyja fakulteteve janë prezentuar si: Alba Merovci, Albina Zeneli, Anisa Rada, Besart Troshupa Erza Bra-hushi, Iliriana Krasniqi, Xhejlane Sopa, Arbër Gjinolli, Visar Hashani, Esad Marevci dhe Rinore Reshani.*

#### Nga fusha e shkencave kompjuterike

Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, në këtë aktivitet u paraqitën mbi 30 punime hulumtuese brenda lëndëve "Seminardhe Telekom", u zhvilluan në këtë aktivitet shkencor. "Prezantimet kanë qenë të nivelit të lart, të përgatitura gjatë gjithë semestrit paraprak, dhe janë tema shumëatraktive në fushën e ICT", tha Krenare Pireva, profesoreshë.

Me prezantimin e punimeve : Oriq Hoxha, Oketi Hoxha, Erzen Badivuku, Besnik Qehaja, Brikend Rama, Vlora Bytyqi, Edvin Smakaj, Valerina Smakaj, Nora Preniqi - Prestreshi, Bardha Babolli, Edmond Sahiti, Adnan Sinani, Ardian Krasniqi, Fatos Rrahmani, Behar Bullaku, Albert Lekaj, Fisnik Dernjani, Visar Krasniqi, Ardit Azemi, Atdhe Mahmuti, Diorit Bajrami, Vlonjat Gashi, Ylli Sahiti, Liridon Morina, Laura Thaqi, Diana Sahiti, Partin Imeri, Valmir Abazi, Valon Ymeri, Leona Ejupi, Egzona Zejna, Argenita Selmani, Blinera Ahmeti, Besarta Mullaliu, Majlindë Jahiu, Valëz Berisha, Adeline Nura, Elhami Gagica, Egzon Jonuzi, Jahja Mziu, Drilon Duraku, Arianit Ibraj, Drilon Tahiri, Gramos Kamberi, Arbnor Rushiti, Adhurim Haliti, Qazim Sokoli, Lend Kelmendi, Granit Veliu, Gent Sekiraqa, Liridon Morina, Florentina Ymeri, Drinor Selmanaj, Hana Maloku, Riola Lama, Albulena

Vrajolli, Emira Halimi, Trandelina Abdili, Besiana Shehu, Zgjim Jusufi, Endit Shkodra, Albert Baliu, Yll Shkodra, Vegim Bejtualllu, Saqip Haziri, Albert Bislimi, Shkumbin Vishi, Jeton Jashari, Arian Haliti, Indrit Rexhepi, Arber Kelmendi, Noar Rakovica, Granit Memeti, Genc Kelmendi, Blerta Bajri, Astrit Hoti, Yzer Berisha, Elbekir Krasniqi, Emri Nuredini, DoklatHalilaj, Trine Ismajli, Ruhada Emini, Kreshnik Balidemaj, Drilon Zeqiraj, Abresha Sejfiqaj, Venera Musliu, Alborita Mehana, Emira Kerhanaj, Egzona Jonuzi, Albajrak Zogaj, Besart Jashari, Shpetim Hoxha, Sadullah Cabra, Visar Ibishi, Liridon Vrapca, Ermira Guri, Rinor Svarqa, Fatos Sadiku, Hajrie Bardhi, Ismete Ramadani, Sihana Haxhishabani, Fitore Bajrami, Blerant Gashi, Valdet Abdurrahmani, Adnan Lupci, Donat Kaci, Edon Sekiraqa, Shkumbin Abazi, Besart Berisha, Gentril Duraku, Shkumbin Miftari, Shkumbin Statovci.

#### Nga fusha e arkitekturës

Nga Fakulteti i Arkitekturës, ngalënda "Studio dizajn 1", janë prezentuar 181 punimet- projektet nga ndërtesat shoqërore "Hoteli", ku secili student ka prezentuar personalisht punën e vet, projektinarkitektonik. "Për t'u vlerësuar mirë, studentët prezentuan si: Konstruksionin (sistemi konstruktiv, materialet e elementeve, hapjet, thyerjet dhe konzolat në fasada), funksionin (njësiti kryesore funksionale, ndërlidhjes njësive, shpërndarja e tyre në etazhe, hyrjet kryesore, qasje dhe lëvizjet nëpër lokacion) dhe estetikën dhe formësimin (forma, ritmi, ngjyrat, harmonia, materializimi), tha profesori i lëndës Binak Beqaj.

Nga lënda "Studio Dizajn 3" janë paraqitë 120 punime hulumtuese, si me projektimin e objekteve ekonomike nga stacio-

nitë autobusëve; fabrikë të bukës; fabrikë të prodhimit të dymit dhe dritareve; stallë të lopëve të lira; stallë të dhive; qendra tregtare, kurse në lëndën "Projektimi Arkitektonik 1", janë prezentuar 160 punime, ku të gjitha hulumtimet janë fokusuar në objektet e banimit individuale në Kosovë. "Prezantimet kanë qenë të nivelit të lart, të përgatitura gjatë gjithë semestrit paraprak," tha Lulzim-Beqiri, profesor i dy lëndëve në fjalë.

#### Me prezantimin e punimeve:

*Studio Design 1: Fatlind Jasiqi, Fjolla Abazi, Edona Klaiqi, Gresa Neziri, Heroina Maloku, Qëndrim Sylja, Liridona Sopaj, Ardian Maliqaj, Blerim Maliqaj, Bujar Statovci, Ermal Canaj, Nora Lika, Harun Korenica, Ali Aliu, Armend Sadiku, Gjentia Zogaj, Vjollca Iseni, Nora Zejnullahu, Kadri Krasniqi, Donjeta Duraj, Qëndrim Sejdiu, Teuta Sylejmani, Rizah Gashi, Liridona Gërguri, Zana Rrmoku, Vigan Zeka, Armira Mula, Festina Avdiqaj, Gentril Krasniqi, Anita Nika, Fehri Rexhepi, Vesa Shasivari, Shkumbin Isufi, Egzon Jusufi, Arian Çanta, Getoar Rizahu, Driton Begisholli, Armend Begisholli, Egzona Morina, Emel Vërbiqi, Jon Berisha, Erëzë Këpuska, Bardha Brestovci, Edon Rexhep, Festina Blaca, Ibrahim Krasniqi, Dodona Blakaj, Vjollcë Krasniqi, Bardha Meta, Kastriot Rrmoku, Labinot Lokaj, Learta Stavileci, Luiza Hoxha, Albana Krasniqi, Muhamet Dervishi, Mirlind Mazreku, Fiton Zogaj, Zana Prelvukaj, Fatbardh Jashari, Ruzhdi Dakaj, Rinor Toska, Mergime Krasniqi, Durim Zeka, Albulena Doli, Florim Kosumi, Shaindere Krasniqi.*

*"Studio Dizajn 3": Drizona Maqani, Leartë Salihu, Blendi Berdynaj, Agon Gacaferri, Taulant Mulaj, Leonoran Lyta, Xheneta Selmani, Valmir Krasniqi, Adrian Sharku, Shkumbin Isufi, Nazif Arifi, Florim Gashi, Albert Mustafa, Leonarda Emini, Vlora Haradinaj, Marigona Dragusha, Arian Sefiu, Shkelqim Ismaili, Ndriqim Halili, Qëndrim Sylja, Liridon Selmani, Albina Vuthi, Nita Mala, Evelina Nushi, Egzon Jusufi, Veton Mazreku, Xheraldin Berisha, Brilantina Bektashi, Arber Kryeziu, Hana Bytyqi, Shkelqim Maliqi, Mevlana Ibrahim, Denis Bytyqi, Merita Aslani, Krenare Mustafa, Gresa Neziri, Edona Klaiqi, Drin Dushi, Rrezon Sopi, Gentiana Xhemajli, Mendim Hysiqi, Ledri Mahmuti, Labëri Dakaj, Vlora Hasani, Arian Canta, Fionna Beqiri, Edina Mamusha, Kujtim*



*Mehmetukaj, Leotrina Hoxhaj, Bestar Guraziu, Mirela Qupevaj, Nuridin Abazi, Merita Shahini, Leart Jakupi, Leon Zeqiri, Ermal Statovci, Ahmet Gashi, And Kërnya, Jetmira Qerimi, Adelina Sylka, Flamur Imeri, Alban Ibrahim, Alma Rapuca, Rilind Duriqi, Anyla Berisha, Irmen Qehaja, Ermal Krasniqi, Ard Gashi, Edona Thaci, Rrustem Brahimi, Korab Basha, Gëzim Haliti, Sorkadhe Pira, Tirana Selimi, Diamant Bytyqi, Leonora Thaqi, Mahmut Ajvazi, Atdhe Qeku, Rrahim Latifi, Agon Hoti, Egzona Rexhepi, Blerta Emini, Endrit Mazrekaj, Bardh Abazi, Blerina Balaj, Kimete Ademi, Valdrin Murturi, Agon Jonuzi, Xhevahire Skoro, Dafina Tufa, Lorik Kamberi, Ardian Mehmeti, Luljeta Thaci-Elezi, Barbana Berisha, Leonard Rexhepi, Nexhmije Nuza, Flamur Shkreli, Mimoza Tolaj, Qendresa Gutaj, Fatmire Beqiri, Vjosana Bujupi, Valdrin Muqaj,*

*"Projektimi Arkitektonik 1": Diellza Qanta, Dardan Krasniqi, Njomza Sylja, Bujar Morina, Vjosa Decani, Jon Fida, Labinot Hykolli, Miranda Kastrati, Pleurat Haxhaj, Edona Halili, Ilir Selimi, Taulany Ademi, Diellza Halimi, Deniza Blakaj, Veronika Palokaj, Eni Arapi, Floriana Kcicku, Arber Krasniqi, Fidan Ademaj, Ilir Rexhaj, Florim Mjeku, Adnan Sekiraqa, Aulon Zeqiri, Mirand Latifi, Rina Bryma, Flaka Ademi, Anduena Kika, Altin Gojani, Gent Krasniqi, Hazbi Kryeziu, Rinor Tasholli, Ermal Imeri, Arber M Krasniqi, Leonard Zenelaj, Jetmir Qelaj, Blegina Hasangjekaj, Hekuran Tërpeza, Andelina Biqkaj, Blerta Isufi, Rineta Berisha, Florentina Sinani, Fitim Morina, Endrit Citaku, Valon Deliu, Valon Mehmeti, Blerim Mustafa, Behar Neziraj, Florent Islami, Albi Shita, Njomza Ferati, Viona Bejtullahu, Granit Krasniqi, Anda Batalli, Lyra Pallaska, Sokol Nikqi, Rinor Sadiku, Alban Elshani, Dalan Shabani, Egzonjeta*

*Ademaj, Enkelejda Zekaj, Medina Brahaj, Nora Rexhaj, Djellza Veliqi, Arlinda Gecaj, Agim Boshnjaku, Granit Baliu, Sunaje Hetemi, Anduena Nagavci, Rejlla Brdagic, Dardan Tetaj, Natyra Poqesta, Edona Dreshaj, Agnesa Hoxha, Valentina Martinaj, Blerim Januzi, Ibrahim Kollari, Blerindona Thaqi, Ermin Emini, Imran Haziri, Yll Sylja, Agim Lutolli, Adon Pajaziti, Fatbardha Fejzullahu, Marigona Gashi, Edona Tafili, Endrit Gashi, Shkumbin Alihajdaraj, Albijon Hajrizi, Blerta Ajeti, Dodona Rushiti, Pranvera Gashi, Vildane Maliqi, Arjana Mikullovi, Flutura Limani, Isra Basha, Ardit Haziri, Abetare Rexhepi, Ermira Muciqi, Arjana Komani, Endrit Sadiku, Shqipdon Bozhdaraj, Rinor Imeri, Baton Shefciu, Klodina Krasniqi, Dalinë Haziri, Ermira Hoxha, Anesa Beqiri, Agnesa Tanushi, Rreze Rexha, Mehmet Jashanica, Jetëllira Abazi, Drilona Berisha, Jasmin Karaxhi, Esidoras Majli, Albulena Rexhepi, Alban Rexhepi, Fat Deva, Shkelzen Bajraktari, Shkodran Tafaj, Filonid Mahmutaj, Arjanit Zukaj, Xheneta Luzha, Fjoralba Raci, Aurora Jakupi, Fatlind Pllana, Etleva Sylejmani, Egzon Nikci, Zeqir Zeqiri, Dren Nishliu, Fidan Rexhepi, Fitim Ymeri, Adonis Rexhepi, Alban Dema, Besart Hyseni, Besim Krosa, Besjana Hasani, Blerim Bajraliu, Fatlinda Jusufi, Festina Avdiu, Florent Berisha, Gentiana Gerbeshi, Kaltrina Qerkini, Labinot Haxha, Leart Miftari, Nexhmije Jakaj, Gojart Grainca, Qendrim Vogliq, Qendrim Begisholli, Shpresa Murseli, Valton Luri, Visar Ramani, Vanesa Kurtaj, Tahir Salihu, Albert Esati, Valdrin Ramiqi, Fidan Sylejmani, Faina Lauka, Ardi Zhubi, Azra Pajaziti, Lirak Goga, Bersant Rrahimaj, Agnesë Hoxha, Alban Dema, Albi Shita.*

**E realizuan: Anisa Rada, Egzona Arifi, Labinot Hoxha dhe Shkelzen Dragaqina**





# PROF. ZHILBERT Tafa: STUDENTËT E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE NË UBT KONKURRENTË NË BOTË

UBT si pjesë të programeve të studimit, rëndësi të veçantë i kushton pjesës praktike-laboratorike e cila ua mundëson studentëve që praktikisht t'i demonstrojnë njohuritë e përfituara gjatë procesit mësimor si dhe t'i avancojnë tutje ato.

Edhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, në dy kampuset universitare të UBT-së, është i pajisur me laboratorë të teknologjisë së avancuar.

Zhilbert Tafa, profesor i rregullt në UBT, i cili ligjëron lëndën "Bazat teknike të informatikës II", thotë është i kënaqur me entuziazmin që kanë strukturat udhëheqëse të UBT-së për të zgjeruar diapazonin e formave të ushtrimeve laboratorike dhe për të insistuar në kualitet të tyre. Tafa, i cili ka përvojë studimesh në universitete të huaja, këta laboratorë i vlerëson tejet lart.

"Mendoj se konceptimi i laboratorëve dhe i kushteve laboratorike është plotësisht i përshtatur si përkrahje praktike e ligjëratave. Që në vitin e parë, studentët, përveç parapërgatitjes teorike, kalojnë nëpër turin praktik të aspekteve të ndryshme të shkencave kompjuterike me zgjerim edhe kah disa degë tjera shumë interesante të teknologjive moderne sikur robotika dhe automatika", tha z. Tafa.

Ai, më tutje shton se në vitet e ardhshme, do të ketë mundësi të realizohen edhe projekte të tjera praktike, më specifike dhe ende më të specializuara nga kjo dhe fushat tjera.

## Të punësuar ende pa mbaruar studime

Falë programit të përshtatshëm akademik dhe aplikimit praktik të njohurive, një numër i konsiderueshëm i studentëve të këtij Fakulteti, punësohen në institucione private dhe publike. Një pjesë e tyre mbesin staf i UBT-së, që prej sektorit të IT-së, deri tek ligjërimi.

"Sidomos në pikëpamje të aftësimin profesional studentët e Shkencave Kompjuterike në UBT, i kanë të gjitha kushtet që të jenë plotësisht konkurrentë me studentët e universiteteve tjera me repute në regjion dhe botë. Në laboratorët e UBT-së ata i kanë të gjitha kushtet për të krijuar një bazë të mirë që mundëson adaptim të shpejtë në tregun ekzistues dhe perceptim të lehtë të koncepteve të reja të teknologjive të së ardhmes", thekson Tafa.

Besnik Qehaja, ish student i UBT, tashmë është asistent i kësaj lëndë. Ai poashtu vë në pah rëndësinë e laboratorëve në aftësimin e studentëve në sektorin e IT.



Edhe Betim Gashi, i cili mban ushtrimet në lëndët "Siguria e Teknologjisë Informative" dhe "Inxhinieria e webit", thekson se eksperiencën dhe përvojat e fituara nga UBT, tashmë po i përcjell tek studentët, të cilëve u dëshiron karrierë të suksesshme profesionale.

"Pjesa e punës praktike ka qenë e rëndësishme shumë për ne si studentë. Të mësuarit për zhvillim të softverit është diçka esenciale, prandaj në laboratorët e UBT-së me kolegët e tjerë nga studimet kemi mësuar shumë. Edhe studentëve të tjerë të UBT-së, u ka ndihmuar

shumë në zhvillim profesional dhe karrierë të suksesshme, dhe i njëjti fat me përcolli dhe mua. Fillimisht njohuritë e mia në Web i ktheva në punë praktike duke zhvilluar webfaqe të ndryshme për UBT-në dhe duke e futur në përdorim softverin E-learning platformën Moodle që tashmë përdoret nga të gjithë dhe u mundëson studentëve që të kenë qasje virtuale në materialet e ofruara nga profesorët dhe hapësirë të personalizuar mësimore", thekson Gashi.

Studentët, në anën tjetër, thonë se presin me padurim që të fillojnë pjesën laboratorike në të gjitha lëndët që i kanë.

"Me këtë mundësi praktike që na e ka dhënë UBT-ja është avantazh i madh që të shkohet sa më shumë drejt profesionalizmit, e që në fund, neve si studentë do të na përgatisë sa më mirë për tregun e punës", thotë Blerand Hulaj, student aktual.

Menaxhmenti i lartë i UBT-së, është shumë i kënaqur me suksesin e studentëve, jo vetëm të Shkencave Kompjuterike, por të të gjitha drejtimeve.

*Punuan: Iliriana Krasniqi, Egzon Hyseni, dhe Erza Brahushi*





## STUDENTËT E UBT-së VIZITUAN KOSOVAPRESS-in DHE TELEGRAFIN

Studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT, gjatë këtyre ditëve vizituan Agjencinë e vetme të Lajmeve në Kosovë "KosovaPress" dhe redaksinë e portalit informativ "Telegrafin", ku u njoftuan me procesin e punës dhe konceptin e këtyre dy medimeve.

Pronari i "Kosovapressit" Skender Krasniqi, i njoftoi ata për përvojën dhe fillimin e punës që nga lufta e deri me sot, si dhe konceptin dhe synimet e agjencisë "KosovaPress". Po ashtu, redaktori përgjegjës Labinot Gashi dha detaje të hollësishme për punën që bëhet në këtë medium, organizimin mes redaktorëve dhe gazetarëve, publikimin e lajmeve në baza ditore, planet për publikime të temave dhe intervistave në baza javore dhe ato për raste të veçanta.

Kurse drejtoresha për Marketing, Syzana Hashani, foli për qasjen e saj ndaj klientit dhe për bashkëpunimin ndërinstitucional, dhe rendësin e kapërcimit të marketingut nga bota e shtypi të shkruar në atë online.

Po ashtu edhe pronari i "Telegrafit" Gent Lluka, përveç tjerave studentët i njoftoi edhe për produktin që ofrohet nën ombrellën e këtij mediumi "smard".

Kurse kryeredaktori Agron Shala, përfaqësuesit për Marketing, Shpend Sadiku, Kaltërina Zylifiu dhe Arlind Gjokolli, dhanë detaje të hollësishme për punën që bëjnë në "telegraf".

Gjatë një bashkëbisedimi, që u zhvillua në pjesën më të madhe të këtyre takimeve, studentët kryesisht u interesuan për mënyrën e sigurimit të informacionit, pozitën e agjencisë dhe të portalit në treg, raportet me botuesin dhe perspektivën e këtyre medimeve.

Pronarët e këtyre medimeve si Skender Krasniqi dhe Gent Lluka, studentët i njoftuan në përgjithësi me ambientin dhe stafin që kanë.

*Realizoi: Melina Belegu dhe Edona Haxhiajdini*



## UBT BASHKËPUNON ME UNIVERSITETE GJERMANE

PRISHTINË, 20 SHKURT 2014

Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndëruniversitar, profesori i njohur gjerman Prof. Dr.- Ing. Thomas A. Bier nga Universiteti i Freibergut, për disa ditë me radhë ka qëndruar në Republikën e Kosovës, gjegjësisht në UBT, me ftesë të presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në një takim të veçantë me prof. dr.-ing. Thomas A. Bier, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit ndër universitare në mes të UBT-së dhe Universitetit të Freibergut.

Më konkretisht marrëveshja në fjalë do të mundësojë shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, të organizojnë seminare të përbashkëta dhe takime tjera akademike për çështje shkencore dhe hulumtuese, zbatimin e përbashkët të programeve studimore, konferenca, aktivitete lidhur me kurset dhe akademike verore përkatëse dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit sidomos në pjesën e punës praktike- laboratorike.

Përveç tjerash, pas nënshkrimit të marrëveshjes, mysafiri nga Gjermania së bashku me menaxhmentin e lartë të UBT-së e kanë vizituar kampusin e ri të UBT-së, mjediset mësimore, laboratorët dhe infrastrukturën përcjellëse duke shprehur

admirim për të arriturat e UBT-së në rrugën e zhvillimit dhe rritës akademike. Po ashtu edhe presidenti i UBT-së, z. Hajrizi, me theks të veçantë ka folur për zhvillimet dhe të arriturat e UBT-së prej fillimit të punës së saj.

### **Profesori Bier, para studentëve të UBT-së, ligjëroi për bazat e materialeve konstruktive**

Prof. Bier, përveç aktiviteteve të cekura si më lartë, para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe stafit akademik të UBT-së si dhe të interesuarve tjerë, mbajti edhe një ligjëratë me temën "Bazat e materialeve konstruktive ndërtimore dhe zhvillimi i tyre historik".

Të pranishmit e kësaj ligjërate patën rastin të marrin informata nga zhvillimi i materialeve të ndërtimit dhe teknologjisë së prodhimit të tyre si dhe aplikimin e tyre në projektet ndërtimore. Poashtu u prezantuan edhe rezultate nga projektet e ndryshme hulumtuese shkencore në lidhje me tematikën si dhe standarde të ndryshme ndërkombëtare për kualifikimin e cilësisë së materialeve ndërtimore pas ligjëratës u zhvillua një debat me profesorin nga ana e të pranishmeve.



## International Summer University



**International Summer University in South East Europe**

**July 13th - 26th 2014  
Durrës, Albania**

[www.ubt-uni.net/isu2014](http://www.ubt-uni.net/isu2014)



# AMBASADORI I HOLLANDËS NË KOSOVË, z. ROBERT BOSCH NË DEBAT ME STUDENTËT E UBT-së

PRISHTINË, 25 SHKURT 2014

Fakulteti i Shkencave Politike, Fakulteti për Media dhe Komunikim dhe Fakulteti i Juridikut në UBT, organizuan debat me temën "How can Kosovo speed up its EU integration process", "Si mundet Kosova të përshpejtojë procesin e integrimit në Bashkimin Evropian", për të cilën temë ligjëroi ambasadori i Holandës në Republikën e Kosovës, z. Robert Bosch, i ciliu prit nga dekani i dyja Fakulteteve të cekuar si me larte si për Media dhe Komunikim dhe Shkenca Politike, prof. dr. Belul Beqaj, profesor, studentë dhe mysafir tjerë.

Ambasadori, z. Bosch, foli për vështirësitë e jashtme dhe të brendshme që përbëjnë pengese për përparimin në këtë proces. Pasi foli për përparësitë dhe problemet e zakonshme të zgjerimit të Bashkimit Evropian, BE-së, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë politik e institucional, madje edhe kulturor, z. Bosch, është ndalur edhe në disa pika të lidhura posaçërisht me rastin e Republikës së Kosovës.

Ai theksoi se ndryshimi dhe zhvillimi duhet të vije nga brenda, të burojnë nga populli i Kosovës, i cili duhet të kuptojë se është ai që kërkon të hyjë në BE, dhe vetë ai që duhet të plotësojë kushtet e BE-së. Edhe pse vendet e Ballkanit

Perëndimor po vuajnë disi pasojat e integrimit të përshpejtuar të Bullgarisë dhe Rumanisë, vendi i tyre në BE është i garantuar nëse plotësojnë këto kushte.

Gjithashtu, ambasadori Robert Bosch, theksoi nevojën e shtetit të Kosovës për të mbajtur EULEX-in në Kosovë, duke qene së qëllimi i këtij misioni është zbatimi i ligjit në Kosovë. Lidhur me këtë çështje, ai argumentoi se, pavarësisht se akuzat e Dick Marty-it mund të jenë të pabazuara, interesi i shtetit të Kosovës është që në rast se merren masa për verifikimin e tyre (psh. Gjykate e veçantë), këto të mbeten në kuadër të EULEX-it, si një mision i BE-së, dhe jo një tjetër i OKB-së.



Ambasadori i Holandës në Republikën e Kosovës, z. Robert Bosch, zhvilloi dhe përgjigjën në vijim të debatit edhe në një varg

pyetjesh e çështjesh të shtruar për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e UBT-së.

## PRESIDENTI I UBT-së, z. HAJRIZI NË KONFERENCËN REGJIONALE "HORIZON 2020" NË MAL TË ZI

PRISHTINË, 4 MARS 2014

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka qëndruar në Budvë me ftesë të Komisionit Evropian, për të marrë pjesë në konferencën, "Horizon 2020 Regional Launch Event for Western Balkans: preparing together for EU accession through cooperation on Research and Innovation", nikoqir i së cilës ishte Ministria e Shkencës e Malit të Zi.

Përveç z. Hajrizi, në këtë konferencë po marrin pjesë edhe ministri i Dikasterëve nga sektori Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë, nga vendet e regjionit dhe për rreth, si dhe palë tjera të interesit.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka qenë anëtar i grupit të ekspertëve për hartimin e Strategjisë për Hulumtim dhe Inovacione 2020, për regjionin e Ballkanit Perëndimor, me ç'rast e ka përfaqësuar Republikën e Kosovës.

Përveç pjesëmarrjes në konferencë z. Hajrizi do të takohet edhe me personalitete të institucioneve pjesëmarrëse dhe do të bisedojë për bashkëpunimin e mëtejshëm nga fusha e arsimit dhe shkencës në përgjithësi.

## UBT KA MARRË PJESË NË KONFERENCË NDËRKOMBËTARE "QUALITY IN BLENDED LEARNING"

PRISHTINË, 5 MARS 2014

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe can. dr. Krenare Pireva, ligjëruese në UBT, morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Quality in Blended Learning", të mbajtur në Winerneustadt të Austrisë.

Gjatë kësaj Konference, e cila është organizua në kuadër të projektit Evropian "Blended Learning", në bashkëpunim me partnerë të shteteve nga Evropa si nga Austria, Finlanda, Portugalia, Spanja, Italia, Holanda, Greqia dhe Kroacia, përfaqësuesit e UBT-së, u paraqitën me dy punime të tyre shkencore si: dr. Hajrizi, me punimin "Institutional and Program (blended learning) Quality Management System Design and Evaluation", kurse znj. Pireva "The impact of appropriate LMSs to learners".



Punimet e paraqitura nga përfaqësuesit e UBT-së, nga ana e pjesëmarrësve të konferencës përveç që janë pritur shumë mirë gjithashtu u vlerësuan edhe si të nivelit të lartë.

Përveç pjesëmarrjes në konferencë, dr. Hajrizi zhvilloi edhe një sërë takimesh me përfaqësues në shtetet e cekura si më lartë, më të cilët bisedoj për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe atë universitar e më tej.

## UBT CERTIFIKON MENAXHERËT E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR QUALITY SYSTEMS MANAGER

PRISHTINË MARS 2014

UBT në kuadër të programeve të shumta të studimit, dhe programeve për ecjen e saj drejt ndërkombëtarizimit, mjaft të zhvilluar e ka edhe sektorin e Trajnimeve dhe të Certifikimeve.

UBT në bashkëpunim me Quality Austria, në Vjenë të Austrisë, për disa ditë me radhë organizoi trajnimin, për "Quality Systems Manager", gjegjësisht për menaxherët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Republikën e Kosovës.

Kandidatët e pranuar kanë ndjekur disa orë të moduleve të njëpasnjëshme dhe në fund

u janë nënshtruar provimit përfundimtar.

Pas përmbylljes së suksesshme të moduleve dhe provimit pjesëmarrësit e këtij institucioni në një ceremoni solemne u certifikuan si "Quality Systems Manager", ku certifikatat u shpërndanë nga presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe nga Auditori i Përgjithshëm z. Lage Olofsson.

Gjatë ndarjes së certifikatave rektori i UBT-së, z. Edmond Hajrizi, në një fjalë rasti i përshëndeti dhe i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e ceremonisë e veçanërisht përfaqësuesin z. Lage Olofsson.





# STUDENTËT NGA UNIVERSITETIN I OSLOS ZGJODHËN PËR VIZITË UBT-në

PRISHTINË 10 MARS 2014

Një grup prej 30 studentëve nga Republika e Norvegjisë, të cilët studiojnë në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Oslos, gjatë qëndrimit të tyre disa ditë në Republikën e Kosovës, krahas aktiviteteve tjera, për vizitë akademike kanë përzgjedhur UBT-në, nën organizimin e ligjëruesve të këtij institucioni Emir Ujkani dhe Liridon Shurdhani.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, studentëve nga shteti norvegjez, përveç që ju dë-

shiroj mirëseardhje ju mbajti edhe një ligjëratë, për sektorin e edukimit në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë për UBT-në dhe programet të cilat ofrohen në këtë institucion të dijes. Ai gjithashtu të pranishmeve ju foli për mundësitë e studimit në UBT duke u nisur nga fakti se kurrikula e programeve akademike në UBT është e avancuar dhe konform standardeve ndërkombëtare. Ndërsa, z. Emir Ujkani, para studentëve mysafir, foli për proceset e integrimi evropiane në Ballkanin Perëndimor, duke u ndalë veçanërisht në rastin e Kosovës,

dhe për sfidat të cilat janë duke u ballafaquar vendet e këtij regjion në përbushjen e agjendës evropiane.

Studentët parashtruan gjithashtu pyetje lidhur me dialogun e Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe për mënyrën dhe kulturën e arsimit në UBT.

Përzgjedhja për vizitën e UBT-së është bërë në bazë të performancës së shkëlqyeshme që ka treguar UBT-ja, në të gjitha drejtimet studimore, për të cilën kanë dëgjuar studentët norvegjez.



## UBT BËHET ANËTAR ME TË DREJTA TË PLOTA NË AESOP

PRISHTINË, 19 MARS 2014

Pas një procedure aplikimi të suksesshëm dhe pas marrjes së letrës së konfirmimit dërguar presidentit të UBT-së, Edmond Hajrizi, UBT ka nderin dhe kënaqësinë t'ju njoftoj se tashmë është anëtare me të drejta të plota pranë Asociacionit të Shkollave Evropiane të Planifikimit (AESOP).

AESOP, është një asociacion ndërkombëtar prestigjioz në fushën e planifikimit dhe i vetmi

asociacion që përfaqëson shkollat e planifikimit në Evropë. AESOP ka një rol lideri në organizimin e debateve dhe iniciativave në lidhje me edukimin dhe kualifikimin në planifikim. Gjithashtu AESOP promovon agjendën e saj me profesionist, politikan dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në të gjithë Evropën.

UBT tashmë radhitet ndër anëtarët e rregullt dhe me të drejta të plota, duke qenë i vetmi insti-

tucion arsimor nga Republika e Kosovës anëtar i këtij asociacioni.

Tashmë studentët dhe akademikët e UBT-së, kanë mundësinë të jenë pjesëmarrës në kongreset vjetore në nivele rajonale dhe evropiane, shkollat verore për planifikim, trajnime etj.

Anëtarësimi në AESOP shton radhën e sukseseve të UBT si dhe shton mundësitë për kualifikim të profesionistëve të rinj që diplomohen çdo vit pranë UBT.



## UBT E VAZHDON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN PECS

PRISHTINË, 26 MARS 2014

Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndëruniversitar, një delegacion nga Universiteti Pecs, nga Republika e Hungarisë, i prirë nga menaxhmenti dhe profesorë të Fakultetit të Arkitekturës, për disa ditë me radhë qëndruan në Republikën e Kosovës, gjegjësisht në UBT.

Delegacioni hungarez u pritë nga presidentin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, drejtori për Çështje Akademike, prof. dr. Ibrahim Krasniqi, dekan i Fakultetit të Arkitekturës, dr. Binak Beqaj si dhe nga prodekanit can. dr. Lulzim Beqir, të cilët biseduan për vazhdimin e zgjerimit të bashkëpunimit mes dy institucioneve universitare, me theks të veçantë nga fusha e arkitekturës, bashkëpunim si: për studime në nivelin Master dhe atë të Doktoratës, për organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, organizmi e përbashkët të ekspozitës Tradicionale të UBT-së etj.

Ky delegacion, ndër të tjera, në kuadër të kësaj vizite ka zhvilluar edhe një ligjëratë me temë nga fusha e Arkitekturës, si dhe prezant-



tu programet që ofron ky universitet nga lëmi i arkitekturës, në të gjitha nivelet e studimit si Bachelor, Master dhe PhD.

Ky delegacion nga Universiteti Pecs, bashkërisht palët pritëse nga UBT, tjerave ka bërë edhe vizitë të Kampusit të universitetit UBT-së, në Lipjan.

Bashkëpunimi ndëruniversitar, ka filluar vitin e kaluar, kur z. Hajrizi, në vazhdim të aktiviteteve me karakter shkencor të zhvilluara jashtë vendit për tre ditë me radhë

pati qëndruar në Pecs të Hungarisë, me ç'rast edhe mori pjesë në Simpoziumin e Nëntë Ndërkombëtar Shkencor "Architecture, Engineering and Information Technology", të organizuar nga ky universitet, në kuadër të të cilit, presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi, prezantoi punimin e tij shkencor me titull "Reflektimi në vlerësimin dhe akreditimin institucional të programeve studimore në vendet në tranzicion: UBT dhe Republika e Kosovës si rast studimi".

## EBSCO NË VAZHDIMËSI BASHKËPUNON ME UBT

PRISHTINË, MARS 2014

UBT në bashkëpunim EBSCO me qëllim që të sigurojë informata mbi mënyrën e shfrytëzimit të platformës elektronike të literaturës, gjatë këtyre ditëve organizoi trajnimin për studentët dhe stafin e UBT-së, të mbajtur nga përfaqësuesi e EBSCO për Kosovë, Pavel Synek.

Gjatë këtij trajnimi, studentët dhe stafi u informuan mbi mënyrën e drejtpërdrejtë të përdorimit të burimeve elektronike (revistave, librave, etj.), si dhe mbi mënyrat e shkarkimit të tyre.

Siç edhe jeni të njoftuar, UBT-ja në kuadër të anëtarësimin në platformat elektronike nder të tjera është edhe anëtare e plotë dhe e kamotshme edhe në EBSCO.

Në këtë njoftim e pamë të arsyeshme, t'i paraqesim edhe linqet për qasje tjera direkt në e-libra (libra elektronike) dhe artikuj online, që kanë karakter shkencor dhe akademik në fusha të ndryshme si: E-library: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&url=http://www.ebscohost.com> IMF e-Library <http://elibrary-data.imf.org/> Cambridge Journals <http://journals.cambridge.org/action/login?from=JSTOR> Jstor Library <http://www.jstor.org/>.

Po ashtu kur flitet për Bibliotekën e UBT-së, ajo posedon një numër të madh të titujve dhe libra shkencore. Vetëm gjatë këtij fillim viti kalendarik, kjo Bibliotekë është furnizuar edhe me 25 mijë tituj të rinj të librave shkencore, të ardhura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga të gjitha fushat që studiohen në UBT dhe kontingjenti tjetër me libra të tillë është në rrugëtim e sipër, po me shifrën e njëjtë. Studentët dhe stafi i UBT-s, përveç titujve në librarive online sot kanë edhe një numër të madh të këtyre titujve që mund t'i marrin në lexim në Bibliotekën e UBT-së, në të dyja Kampuset, si në këtë të Prishtinës ashtu edhe atë në Kampusin e ri në zonën e Lipjanit.



# UBT PREZANTON REZULTATET NË SEMINARIN ACADEMIC EXCHANGE FOR PROGRESS (AEP)

PRISHTINË, 31 MARS 2014

UBT është ftuar në Tiranë datë 27 mars 2014 në kuadër të programit Academic Exchange for Progress (AEP), program i financuar nga Ambasada Norvegjeze, i cili ka në fokus financimin e bursave për universitetet partnere të këtij programi, pjesë e së cilës është dhe UBT.

Pjesë e këtij takimi ishin aktorë të ndryshëm politikë, social, ambasadorë dhe përfaqësues të bizneseve më të fuqishme. UBT u përfaqësua nga presidenti i UBT-prof. dr. Edmond Hajrizi dhe dr. Muzafër Shala, dhe nga studentë përfitues të programeve AEP.

Një rëndësi e veçantë iu dha gjatë këtij takimi bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe universiteteve. Ambasadori Norvegjez në

Tiranë Jan Braathu dhe Prishtinë shpjegoi rëndësinë e këtij programi i cili do të mbështetet nga Qeveria Norvegjeze dhe që do të ndihmojë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve në fushën e ICT. Në kuadër të bashkëpunimit të bizneseve dhe universiteteve Ambasadori Braathu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet nevojave të tregut të punës për burime njerëzore dhe atë çfarë universitetet ofrojnë. Kjo iniciativë u mbështet dhe u përshëndet nga znj. Lindita Nikolla Ministre e Edukimit dhe Sportit në Shqipëri si dhe nga Rektori i Universitetit të Tiranës z. Dhori Kule.

Në prezantimin e tij në lidhje me zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe teknologjisë në UBT, rektori i UBT-së, z. Edmond Hajrizi u



shpreh se "Ne besojmë se me anë të edukimit të mirëfilltë si dhe me trajnimet shtesë në ICT, Microsoft dhe CISCO të cilat ofrohen krahas programeve akademike në UBT, do të sigurojmë që këto studentë të ndihmojnë tregun dhe përgjegjësia jonë është t'i sistemojmë në mënyrën adekuate

këto të rinj". Z. Hajrizi theksoi se "bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar me institucionet e arsimit të lartë dhe industrinë, mbetet një faktor i rëndësishëm për UBT. Për këtë arsye AEP është një mënyrë shumë e mirë për të ofruar bashkëpunim të këtyre niveleve.

UBT si një institucion serioz dhe me një përvojë disa-vjeçare në fushën akademike dhe trajnimeve profesionale tashmë ka një qendër të veçantë karriere e cila i mundëson studentëve të bëjnë zgjedhjen e duhur profesionale në raport me kërkesat e tregut si dhe i mundëson internshipe dhe punësim, duke mos lënë mënjanë dhe mundësinë e krijimit të zyrës për Alumni e cila renditet në prioritetet e këtij institucioni. Në vijim të prezantimit të tij rektori i UBT-së theksoi kompleksitetin e ICT dhe mungesën e kadrove në këtë fushë. Për këtë arsye UBT ka rekrutuar një sërë kadrosh të cilët kanë përfunduar studimet e tyre të doktoratës jashtë vendit duke sjellë kështu një eksperiencë ndryshe dhe të vyer për UBT.

INTERVISTË ME STUDENTEN DORUNTINA KUPINA, KRYETARE E ORGANIZATËS STUDENTORE TË UBT-SË

## PROJEKTET DHE AKTIVITETET GJATË MANDATIT TË KUPINËS

**UBT News: U bënë disa muaj që jeni zgjedhur kryetare e studentëve të UBT-së, a mund të na njoftoni se çfarë aktiviteteve janë ndërmarrë, meqë nuk kemi shumë informata mbi atë se çka është realizuar. Na thaj konkret për projektet/aktivitetet që mendoni t'i realizoni gjatë mandatit të Juaj?**

**Kupina:** Fillimisht më duhet të theksoj se është përparësi dhe privilegj që jam studente e UBT-së, dhe e kam shumë më të lehtë të arrij të realizoj aktivitetet të cilat në bashkëpunim dhe koordinimi shumë të mirë me kryesin e zgjedhur të studentëve kemi të planifikuar. Edhe pse kërkesat e studentëve, nuk janë gjithnjë të mundshme për t'u realizuar, ne jemi përpjekur të ofrojmë ato ide të cilat mendojmë se do të jenë të arritshme. Aktivitetet të cilët planifikojmë të i realizojmë, kryesisht kanë të bëjnë me: identifikim e problemeve që studentët hasin gjatë procesit mësimor, hulumtimi përmundësi pjesëmarrjeje të studentëve në trajnime, seminare, aktivitete sportive, vizita studimore jashtë vendit dhe të tjera, të cilat do të jenë pjesë e kërkesave dhe mundësive për t'u realizuar.

**UBT News: Cilin aktivitet mendoni ta realizoni për këtë fazë?**

**Kupina:** Të gjitha aktivitetet kanë rëndësinë e vetë, dhe nuk mendojmë të bëjmë ndonjë ndarje në aspektin e kohës, por gjithsesi do të beje përpjekje që të gjitha aktivitetet të realizojmë.

**UBT News: Po bashkëpunimi me ekipin që ke për rreth, dhe me menaxhmentin e UBT-së, për realizimin e aktiviteteve po ju ecën?**

**Kupina:** Ekipi i zgjedhur në kryesin studentore është shumë bashkëpunues, shumë aktiv. Ata janë përfaqësues të të gjitha drejti-



meve, prandaj edhe mundësia për të marrë mendime nganjë pjesë e madhe e studentëve është më e lehtë. Kemimbështetjen nga menaxhmenti i UBT-së, prandaj dhe besojmë se do ta kemi më të lehtë të realizohen aktivitetet e planifikuar.

**UBT News: Bashkëpunimi me organizata tjera studentore dhe cilat janë ato, dhe rast se jeni**

**takuar me këta përfaqësues çka është biseduar?**

**Kupina:** Nuk kemi pas ndonjë takim konkret me organizatat tjera studentore, sepse siç e dini muaji Janar dhe Shkurt janë muaj më të ngarkuar me angazhime rreth mësimave (çka është edhe më primare), por kemi pasur mundësi të jemi pjesë e një debatit të organizuar nga Zyra e Komisionit Evropian në Prishtinë, pjesëmarrës kanë qenë

edhe përfaqësues të studentëve nga Universiteti i Prishtinës dhe institucioneve tjera private arsimore. Aty kemi pas mundësi të shprehim dhe bëjmë një krahasim për kushtet që ofron UBT ngatë tjerët, nga ku kemi parë se UBT-ja ofron mundësi dhe kualitetit arsimor shumë më të lartë se universitetet tjera andaj është privilegj i imi dhe i çdo studenti që jemi pjesë e UBT-së.

**UBT News: A keni kohe të mjaftueshme për studime dhe njëkohësisht të merrni më këtë angazhime shtesë?**

**Kupina:** Edhe pse është shumë e vërtetë se studimet kërkojnë angazhim dhe kohë më të madhe, mundohem që të gjej edhe kohën për t'u marrë me aktivitetet shtesë.

**UBT News: Si e kaloni kohën e lirë?**

**Kupina:** Kryesisht me familje, me shoqëri, pak sport, lexim të lirë,...

**UBT News Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, po udhëton me autobus, e ju si kryetare e studentëve të UBT me çka?**

**Kupina:** Për një student, zgjidhja më e mirë është të udhëtohet me autobus, edhe pse e preferoj ecjen, atëherë kur koha më premtan!

....

Dhe në fund, dëshiroj t'ju falënderoj për mundësinë që ma ofruat për të prezantuar shkurtimisht punën e kryesisë së studentëve të UBT-së. (Edona Thaçi, Flakron Jahaj, Afrim Bajraktari, Blend Humolli).

U drejtohem të gjithë kolegëve (studentë) të UBT-së, që të mos hezitoni dhe çdo ide apo kërkesë që mendohet të jetë në të mirë të studentëve dhe UBT-së të na drejtohen, dhe së bashku do të bëjmë përpjekje që të realizojmë deri në fund. Me shumë kënaqësi e them se çdo ide për ndonjë aktivitet do të ketë vlerën e vetë.

Besoj se herën e ardhshme doju ofrojmë më shumëmbi aktivitete e kryesisë dhe të gjithë studentëve të UBT-së.

*Intervistën e realizuan:  
Zylfije Thaçi dhe Arbnora Duriqi*



INTERVISTË ME MURAT RETKOCERIN, MENAXHER I ZYRËS PËR ÇËSHTJE STUDENTORE (ICT), NË UBT

# TË PUNOSH NË UBT ËSHTË PRIVILEGJ DHE KËNAQËSI

**UBT News: Që sa vite jeni punësuar në UBT?**

**Retkoceri:** Pyetje interesante e cila me kthen gati një dekadë prapa, saktësisht unë kam krijuar marrëdhënie të rregull pune në muajin shtator të vitit 2005

**UBT News: Cila ka qenë pozita e juaj e parë dhe cila është tani?**

**Retkoceri:** Pozita ime fillestare ka qenë Administrator IT-së, dhe pas një viti pune në UBT, performancës së treguar dhe vlerësimit nga Menaxhmenti i UBT-së, më është ofruar pozita e Menaxherit të Zyrës për çështje studentore dhe ICT.

**UBT News: Personalisht a jeni të kënaqur me punën që e bëni brenda UBT-së?**

**Retkoceri:** Vet kohëzgjatje e punës sime në UBT tregon edhe përgjigjen në pyetjen e juaj, të punosh në një institucion Universitar i tillë çfarë është UBT është një privilegj dhe njëkohësisht kënaqësi e cila të bënë të ndihesh mire kur je pjesë e një institucioni të arsimit të lartë i cili është lider në ofrimin e studimeve cilësore.

**UBT News: Sikur të kërkojë menaxhmenti i UBT-së, të bëni ndryshime për së miri në departamentin të cilin e drejtoni, çka kishit ndryshuar?**

**Retkoceri:** Zyra për Çështje studentor dhe ICT në vazhdimë-

si ka zhvilluar dhe implementuar sisteme të cilat kanë ndikuar në rritjen e nivelit të shërbimeve ndaj studentëve.

Rritja e kapaciteteve të shërbimeve online do të ishte pjesa ku do të kishim bërë ndryshimet përmes të cilave studentët do shërbehen me informacione të nevojshme si në pjesën akademike po ashtu edhe në atë administrative pavarësisht vendndodhjes.

**UBT News: Si janë raportet e juaj kolegjiale me stafin e UBT-së?**

**Retkoceri:** Raportet me stafin janë shumë të mira, në përgjithësi është një atmosferë e mire pune, por jo vetëm pune në këto raporte i bartim edhe në aktivitetet tjera sidomos ato sportive ku gjatë javës një pjesë e stafit merren edhe me aktivitetet të përbashkëta sportive.

**UBT News: Nën ombrellën e juaj renditën edhe një varg punëtorësh, a jeni të kënaqur punën e tyre dhe njëkohësisht ata me ju?**

**Retkoceri:** në përgjithësi raportet me stafin janë të mira, ekziston një bashkëpunim mjaftë i mirë dhe i ndërsjellët, duke pasur parasysh se shumica e detyrave përfundohen me kohe sipas planit të parapare atëherë nuk mbetet tjetër veçse ky staf të vlerësohet pozitivisht, po besoj se edhe stafin ndan të njëjti mendim për mua, por sidoqoftë ndoshta në ndonjë

intervistë të ardhshme këtë pyetje mund ta merrni nga njeri prej punëtorëve

**UBT News: Po puna me studentët dhe sjellja e tyre ndaj teje?**

**Retkoceri:** Është një periudhë bukur e gjatë e punës të cilën e kam zhvilluar me studentët, ku në përgjithësi raportet kanë qenë jashtëzakonisht të mira, në vazhdimësi kemi qenë në përkrahje të studentëve, mund të themi se kjo ka qenë njëra nga pjesët më të mira të pjesës së kaluar në UBT. Të paktën deri më tani feedback nga studentët ka qenë pozitiv e po ashtu edhe sjellja e tyre ndaj meje.

**UBT News: Si është një ditë e zakonshme për ju në UBT?**

**Retkoceri:** Unë zakonisht fillojë punën prej orës 9:00 po ashtu si edhe pjesa tjetër e stafit, bëjmë një takim të shkurtër me stafin lidhur me aktivitetet të cilat janë të parapara të kryhen gjatë ditës, duke vazhduar më pas me kryerjen e detyrave sipas planit të paraparë.

**UBT News: Planet e juaja për zhvillimin e këtij departamenti?**

**Retkoceri:** Duke pasur parasysh se plani i ynë i punës ka një ndërlidhje me planin strategjik të UBT-së, në të cilin është paraparë edhe numri i studentëve për regjistrim në vitet në vazhdim,



ne kemi planifikuar që të rrisim kapacitetin e infrastrukturës së IT-së në proporcion me numrin e studentëve të regjistruar duke përfshirë këtu edhe krijimin e kushteve për vijimin e ligjëratave të caktuara përmes video konferencave nga universitetet partnere me të cilat kemi një bashkëpunim shumë të mirë.

**UBT News: Një thënie për fund?**  
**Retkoceri:** Uroj që ju si gjenëratë e parë në Fakultetin për

Media dhe Komunikim të jeni ata të cilët do të përfaqësoni në mënyrë të dinjitetshme fillimisht veten tuaj, institucionin ku keni studiuar si dhe vendin tonë, kur dihet se në Kosovë ka nevojë për kadro të kësaj fushe.

*Intervistën e realizuan:  
Fatjetë Azemi  
dhe Gentianë Hoxhaj*

## ESE

### PSE ZGJODHA TË STUDIOJ FAKULTETIN MENAXHMENT BIZNES DHE EKONOMI ?

Zgjedha të studioja pasi reflekton pritjet e mia që ikam për vetën në të ardhmen. Ka mjaftueshëm arsye të tjera të cilët shpjen deri tek rruga në të cilën ndodhem tani. Si çdo njeri edhe vet jam me një personalitet që ka shumë pika të forta, por edhe të dobëta. I bëra këto pika bashkë dhe fitova pikturën e vetes sime duke studiuar Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.


Kjo është sa i përket pjesës më tepër imagjinatave të trurit tim, mirëpo duke e vështruar edhe nga ana racionale ky drejtim ishte i duhuri për mua. Desha të studioja aty ku do të kisha edhe projekte në praktike, ku të mund të beja internshipe dhe në fund të dilja me një diplomë me të cilën kam mundësi të konkurroj në një treg të punës që vazhdimisht ndodhet në zgjerim. Ndiheha që me motivacionin që kisha, nuk do të përfundoja me një diplomë si thjesht një copë letër që pluhuroset në raft, por që do të ma siguronte bukën e gojës.

Shumica e njerëzve mund të thonë që gjysma e Kosovës shkojnë në këtë drejtim, mirëpo nuk me behet vone, se nëse e do një drejtim atëherë do ta mësosh nga rrënja, e kur e mëson nga rrënja nuk do të këtë mundësi të mos pranohesh në një punë adekuate. Dhe nëse atë pune e bënë me plot dëshirë, atëherë ajo nuk do të jete me punë.

**Marigona Hajrizi, studente në UBT**

## OPINION

### A DUHET SHPËRBERËRE OKB-ja?



Për shkak të vetës, në rastin me delikat dhe mëflagrant në botën demokratike është ajo pasqyrimi sot në Siri, ku për shkak të tekave të një vendi komunist, okupator, diktatorial të pashembullt të presidentit të Rusisë, Vladimir Putini, jep një shembull shumë të keq për botën demokratike dhe anëtarëve të OKB-së, ku marrin pjesë si Shtete e Bashkuara të Amerikës, Evropa disa nga vendet e Afrikës, secila nga këto pran tyre dhe botës demokratike tmerri që po ndodh në Siri, po vazhdojnë në Ukrainë, dhe kush nuk mund të garantojë që të vazhdojë edhe më tutje edhe në republikat kaukaze. qoftë edhe

në Poloni, Jemi të gjithë dëshmitar okular, e bota demokratike si mund të lejohet që të digjen, të përgjysmohen dhe të shkëmbohen gra, fëmijë, pleq, plaka. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), po e shkel më të dy këmbët paragrafin një. Ndaj në vazhdim e sipër do të doja të merrja një shembull konkret nëse vazhdohet me këtë OKB, këta anëtar që sot janë mendoj që do të ndodh më shumë tmerr dhe më afër nuk përjashtohet mundësia që një ditë të troket edhe në derën evropiane në botën demokratike. Mendoj, që OKB-ja e sotme duhet shpërbërë, kam besim të plot në vendet demokratike që të kapin këtë çështje më shumë seriozitet dhe guxim të krijohet një OKB e re ku do të kenë të drejtë të marrin çdo vend demokratik që të jenë anëtaree OKB-sëpa përdorimin e vetes se vet, tëpunohe për imazhin e ngritur të asaj OKB-je të re sepse sipas mendimit tim kjo OKB nuk ka ndonjë imazh që me le një përshtypje se është bota demokratike në funksion të çdo kombi dhe kombësie, dhe lirive të tyre të barabarta, me të drejtat e tyre ku do që jetojnë dhe janë ata. Vendet komuniste në mënyrë


që bota demokratike as sa është teknologjia e avancuar të avancojë edhe më përpara në liri dhe drejta të barabarta të çdo qytetari të kësaj bote, se tash nuk mund ta quaj më të paktën demokratike me atë çfarë po ndodh pranë dhe në syrin e çdo qytetari. Bota demokratike nuk mund të fshihet mbrapa këtij tmerrri sikur nuk po sheh këtë që po ndodh. Ndaj, edhe bej thirrje çdo qytetari çdo medium nëse ka vlerën e demokracisë reale, të mos shkruaj të mos e hap gojën asnjëherë asnjë gjë për lirin dhe demokracinë në këtë botë sepse tash më ajo është ngulfaturështë vrrarë po digjet çdo ditë e më shumë, dhe secila nga ne do të ndihet jovetvetja, jodemokratike me këtë çfarë shohim në Siri, pranë syve pranë botës demokratike. Duke parë edhe një herë rishikimin e strategjisë afatgjatë për demokracinë si komb i lirisë, bëjë thirrje që shtetet e bashkuara amerikane të tregojnë veten si komb i lirisë për të marr betejë cila do çofshin ato të ashpërta të tregoj se ata vërtet janë të lirisë dhe demokracisë.

*Qëndresa Ferati, studente në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT*



# ARSYET QË KENIA UDHËHEQ NË BOTË ME TRANSFERIM PARASH PËRMES TELEFONAVE MOBILË

Është më e lehtë të paguash një tiketë taksi duke e përdorur telefonin mobil në Nairobi sesa në Nju Jork. kjo mundësohet nga M-Pesa, një sistem që i prinë botës në aspektin e transferimit të parave përmes telefonisë mobile, produkt ky i kompanisë Safarikom i lansuar në vitin 2007 në Keni.



## Hyrje

M-Pesa është një mënyrë inovative për të transferuar para, përdorët lehtësisht dhe paraqet mundësi të përshtatshme për të transferuar para me anë të telefonit mobil. Paratë mund të transferohen tek secili numër telefoni mobil apo në llogaritë bankare, dhe nuk kërkohet detyrimisht për pranuesin që të ketë një llogari M-Pesa. Për më tepër, koncepti M-Pesa është një shërbim mikrofinanciar i kompanive Safarikom dhe Vodacom të cilat janë operatorët më të mëdhenj të rrjetave telefonike mobile në Keni dhe Tanzani. M-Pesa aktualisht paraqet sistemin më të zhvilluar në botë të pagesave në fjalë. Ky sistem mundëson përdoruesit që të depozitojnë, tërheqin dhe të transferojnë para lehtësisht pa formalitete të shumta, vetëm me një kartë nacionale identiteti apo pasaportë.

Shërbimet që mund të kryhen përmes sistemit M-Pesa janë:

- Depozitim parash.
- Dërgim parash tek ndonjë numër telefoni mobil.
- Dërgim parash tek ndonjë llogari bankare, duke përfshirë këtu edhe dërgesat tek shitësit e produkteve dhe ofruesit e shërbimeve.
- Pagesë për shërbimet e parapaguara.
- Tërheqje parash nga një rrjet agjentësh i gjerë, etj.

Përdoruesit ngarkohen me disa pagesa të vogla kur tërheqin dhe depozitojnë para. M-Pesa është një sistem më shumë agjentësh të shpërndarë gjithandej por pa filiale bankare, pra, shfrytëzuesit janë në gjendje që të kryejnë transaksione bazike bankare pa pas nevojë që të shkojnë tek ndonjë degë bankare.

## Por pse dhe si ndodhi që ky sistem të jetë i pari në botë për transaksione të tilla parash?

Disa faktorë që kanë bërë që ky aktivitet të zhvillohet shpejt dhe në masë të madhe, lidhen ekskluzivisht me vendin aktual të tyre, pra ka disa faktorë që në fakt mund të kopjohen edhe nga operatorë dhe kompani tjera të vendeve tjera të botës, por janë disa tjerë faktorë ekskluziv që edhe nuk mund të kopjohen! Shumë sisteme për transaksione parash janë lansuar, por pse ai i Kenias ishte më i suksesshmi? Ka shumë faktorë favorizues, po i përmend disa:

• Dërgimi i parave me metoda tjera është më i kushtueshëm sesa përmes sistemit të M-Pesa-s.

• Pozicionimi dominues në treg i operatorit Safarikom.

• Vendimi fillestar i rregullatorit që ta lejojë operimin eksperimental të skemës së tillë si pilot projekt pa ndonjë aprovim formal.

• Pastaj, kampanja inovative dhe e qëlluar e përcjell me slogane goditëse të tilla si “dërgo para në shtëpi”.

• Dhe një faktorë intrigues, dhuna e pas-zgjedhjeve në vend kah fillimi i 2008-ës.

• Zhvillimi i një baze fillestare përdoruesish, pastaj i dha shtytje të madhe M-Pesa-s që në fakt përfitoj nga efekti i rrjetit “efekti i ortekut”, sa më shumë njerëz që e përdornin atë, aq më i rëndësishëm bëhej dhe i nevojshëm të përdorej edhe nga të tjerët të mbetur pa u kyçur ende në sistemin.

Fakti që M-Pesa përdoret edhe për të pagua rrogat apo faturat, i kursen përdoruesve kohë dhe para, sepse ata nuk kanë nevojë që të presin në radhët e gjata para bankave.

M-Pesa ka filluar që të funksionoj dhe të rritet edhe në vendet tjera, si në Tanzani dhe në Afganistan, bile është lansuar edhe në Indi. Në të njëjtën kohë, operatorët tjerë në vende tjera janë duke përparuar shumë pasi që e kanë imituar modelin e këtij sistemi. Disa faktorë të suksesit të këtij sistemi në Keni nuk mund të kopjohen, por shumica e tyre mundën.

## Pikëpamje subjektive

Edhe pse në dukje M-Pesa duket skemë e sofistikuar dhe kjo edhe duke e mbajtur parasysh faktin se ka shënuar rritje të shpejtë në Keni dhe Tanzani si dhe në disa vende tjera fqinje, prapë se prapë i ka edhe disa mangësi që në dukje nuk janë të mëdha por paraqiten si mangësi të sistemit! Mundësia e keqpërdorimit të fondeve është e evidente, e kjo për mendimin tim reflektohet negativisht në jetën socio-ekonomike të njerëzve pa marr parasysh se a janë abonent apo jo në këtë sistem shërbyes, ky keqpërdorim mundësohet pikërisht nga fakti i jo-formaliteteve dhe lehtësisë së përdorimit të sistemit, për ta qartësuar opinionin tim; të kesh një telefon personal në këto vende është sikurse të kesh para në xhep, e të kesh para në xhep nuk është ide e mirë dhe në një far mënyre paraqet rrezik të keqpërdorimit dhe/ose të keqtrajtimin midis njerëzve, mbështetje për këtë konstatim timin japin rastet e dhunës të shënuara gjithandej botës për personat që mbajnë me vete para!

Unë mendoj që një sistem i tillë i transaksioneve përmes telefonave mobil vie në shprehje për vendet e varfra dhe për vendet që kanë shkallë të ulët të përdorimit të teknologjisë bashkëkohore, e nuk është i përshtatshëm për shoqëritë e zhvilluara, përndryshe, ky sistem do të bartej në Amerikë e vende Evropiane! Në vendet e zhvilluara aktualisht ekzistojnë sisteme shumë më të sofistikuara dhe më të sigurta sai i përket të gjitha llojeve të transaksioneve e pagesave. Ekzis-

ton mundësia që të kryhen shërbimet e njëjta bile shumë më shumë sesa me M-Pesa, duke shfrytëzuar internetin, përmes kompjuterëve apo telefonave të mençur. Po, edhe kjo teknologji e fundit mund të jetë e “rrezikshme” në kontekstin e keqpërdorimeve, por, sistemi i sigurisë nacionale dhe internacionale mundëson shumë pak hapësirë që kjo të ndodhi, bile mundësia në fjalë mund të mos përfillet fare! Prandaj, unë mendoj që ky sistem mund të kopjohet mirëpo për vendet e zhvilluara amerikane dhe evropiane ky sistem nuk është i përshtatshëm sepse ekzistojnë sisteme e platforma më të sofistikuara, më efikase e shumë më të sigurta, po i përmend disa: kartelat debitore dhe kreditore, sistemet autonome bankare, shërbimet e ndryshme softuerike, pay-palli,...dhe koncepti i digjitalizimit të parës.

Duhet theksuar që këto sisteme bashkëkohore që i përmenda më lartë ndoshta nuk do të funksiononin në Keni, Tanzani e vende tjera ku varfëria e analfabetizmi është i lartë, prandaj duhet konsideruar edhe këto fakte si faktorë relevant që i kanë mundësuar M-Pesa-s të “lulëzojë” në këto vende!

Burimet e informacionit:

[www.economist.com](http://www.economist.com)

[www.worldpress.com](http://www.worldpress.com)

[www.wikipedia.org/M-Pesa](http://www.wikipedia.org/M-Pesa)

[www.mpesa.in](http://www.mpesa.in)

[www.safarikom.co.ke](http://www.safarikom.co.ke)

Afrim Bajraktari, student në Fakultetin e Menaxhimit të Mekanikës, anëtar i Këshillit Akademik në UBT


# PROFESORË TË ROC-it TRAJNUAN STAFIN E UBT-së

PRISHTINË, 11 PRILL 2014

Në kalendarin e aktiviteteve të UBT-së, një vend të rëndësishëm kanë edhe trajnimet e ndryshme për rritjen e kapaciteteve të stafit. Në traditën e këtyre aktiviteteve, për tre ditë më radhë në ambientet e UBT-së është organizuar për stafin akademik të UBT-së trajnimi për Mësimdhënie të bazuar në projekte, nga përfaqësues të RoskildeUniversity (ROC) në Danimarkë.

Prof. dr. AnitaMac dhe prof. dr. Willy J. Rasmussen nga ky universitet i kanë ndarë me stafin akademik të UBT-së eksperiencat e tyre të mësimdhënies dhe të hartimit të programit akademik.

Trajnimi me stafin profesional të Universitetit Roskilde (ROC) kishte për qëllim që mësimdhënien të bazohet në projekte, shkëmbimin e aspekteve kulturore, metodat arsimore në të dy vendet Kosovë dhe Danimarkë



etj. “Ishte interesante t’i analizojmë ngjashmëritë dhe dallimet e kulturës të të mësuarit të studentëve dhe metodologjisë së mësimdhënies të të dy universiteteve: UBT dhe ROC. Po ashtu, trajnimi ka rritësuar vlerat thelbësore të edukimit, të cilat në mënyrë të vazhdueshme duhet të rritetshohen dhe të rishqyrtohen në mënyrë që të përforcohen”, ka thënë Nita Abrashi, ligjëruese në UBT dhe pjesëmarrëse e trajnimit.

Ndërsa Alban Lauka, ligjërues në UBT, ka thënë se “duke i bal-

lafaquar përvojat, metodat dhe kulturat e ndryshme dhe strukturat organizative të programeve akademike, këto ditë patëm mundësi të shqyrtojmë zgjidhje të ndryshme për diversifikimin e metodologjive mësimdhënese dhe mësimdhënies, përshtatjes me tregun dhe kulturën dhe personalizimin e përvojës akademike studentore”.

Ashtu edhe Krenare Pireva, ligjëruese në UBT ka thënë se trajnimi ka qenë mjaft interesant. “Ta them të drejtën e vlerësoj shumë

kontributin e dy profesorëve nga Danimarka, të cilët në mënyrë të veçantë kanë transmetuar ideologjinë e organizimit të mësimdhënies në Universitetin ROC te ne”, ka deklaruar ajo.

Trajnimi është organizuar me prezantime, punë ekipore dhe debate të shumta lidhur me mundësinë e përmirësimit të mësimdhënies dhe alternativave të ndryshme të evolimit të studentëve me një qasje më ndryshe.

Në fund të këtij trajnimi, stafi i UBT-së doli me propozimin e një projekti pilot për vitin e ri akademik, i cili do të asistohet dhe nga ekspertiza e RoskildeUniversity. Ky trajnimi do të vazhdojë edhe me pjesën e dytë, i cili do të fillojë me idenë e funksionalizimit të modeleve të propozuara gjatë prezantimeve.

Në përfundim të trajnimit rektori i UBT-së, z. Edmond Hajrizi, në një fjalë rasti i ka përshëndetur falënderuar të gjithë pjesëmarrë-

sit e trajnimit, e veçanërisht përfaqësuesit nga RoskildeUniversity.

Bashkëpunimi ndëruniversitar, ka filluar në vitin e kaluar, kur z. Hajrizi, për një javë me radhë pati qëndruar në Danimarkë, dhe në Universitetin RUC, në përkrahjen financiare nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), e cila është mbështetëse e UBT-së, zhvillimin e Arsimit Profesional dhe Mësimin Gjatë Gjithë Jetës në Republikën e Kosovës, dhe me ftesë të disa institucioneve të Arsimit të Lartë të Danimarkës. Në sajë të këtij qëndrimi dhe z. Hajrizi, patë zhvilluar një varg takimesh me menaxhmentin, stafin akademik si dhe përfaqësues të niveleve të larta të Universitetit Roskilde (RUC), dhe patë diskutuar për bartjen e praktikave të mira të Danimarkës e posaçërisht të këtij Universiteti në UBT, sidomos në fushën e interdisciplinartetit, studimi i organizuar në projekte dhe inovacion.



# GJUHA E STRUKTURUAR PROGRAMUESE STRUCTURED QUERY LANGUAGE (SQL)

## SQL Deklarimet

SQL (gjuha e strukturuar) është gjuha më e përdorur zakonisht për sistemet e menaxhimit të bazës së të dhënave relacionale. Një metodë e zakonshme e përdorur për kategorizimin e SQL deklarimeve është të ndajë sipas funksioneve që kryejnë. Gjuha përdor deklaratat që të përcaktojnë objektet e bazës së të dhënave, qasjen e përdoruesve në ato objekte, dhe të dhëna për përditësim. Bazuar në këtë metodë, SQL mund të ndahet në tri lloje të deklarimeve:

- Data DefinitionLanguage (DDL)
- Data ControlLanguage (DCL)
- Data ManipulationLanguage (DML)

Data DefinitionLanguage deklarimi përcakton strukturën dhe instancën e një baze të të dhënave në formën e objekteve të bazës së të dhënave, sikurse baza e të dhënave, përdorues, tabelë, paraqitje (view), shkrehës (trigger), procedure (stored procedure).

Data ControlLanguage deklarimi përdoret për të dhënë dhe ndaluar qasje në objektet e bazës së të dhënave.

Data ManipulationLanguage deklarimi përdoret për të rimarrë, shtuar, modifikuar ose të fshini të dhënat e ruajtura në objektet e bazës së të dhënave tuaj.

## Llojet e ekzekutimit

Përveç kësaj për përcaktimin se si gjuha mund të përdoret, SQL: 2006 standardi jep detaje se si SQL deklarimet mund të ekzekutohen. Standardi definon katër metoda të ekzekutimit:

Thirrja e drejtpërdrejtë duke përdorur këtë metodë, mundëson komunikimin tuaj direkt nga një aplikacion i fundëm (front-end).

Deklarimet e SQL janë të koduara (ngulitur) direkt në gjuhën programuese.

Module binding kjo metodë ju lejon të krijoni blloqe të deklarimeve SQL (module) të cilat janë të ndara nga gjuha e programimit.

Call-levelinterface (CLI) ju lejon të thirrni SQL deklarime përmes një ndërfaqe duke kaluar SQL deklarimet si argument vlerë.

## Sistemi Menaxhimit të Bazave të të Dhënave Relacionale

Një sistem i menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale është një program ose grup i programeve që ruajnë, menaxhojnë, rikthejnë, modifikojnë dhe manipulojnë me të dhëna në një ose më shumë baza të të dhënave relacionale sikurse ORACLE, Microsoft SQL Server, IBM's DB2.


Sa do që bazat e të dhënave rriten, bëhen më të komplikuar dhe janë të shpërndara në zona më të mëdha, produktet e RDBMS përdoren për të menaxhuar këto baza të të dhënave të cilat bëhen më komplekse dhe të fuqishme, duke përbushur kërkesat e tregut si dhe zbatimin e teknologjive të reja dhe shumë të sofistikuar.

## Mjedisi SQL

Mjedisi i SQL është mjaft i thjeshtë, shumica e të gjitha pjesëve përbëjnë atë mjedis. Çdo pjesë e dallueshme, ose komponentë punon në koordinim me komponentet tjera për të mbështetur operacionet e SQL sikurse krijimi dhe modifikimi i objekteve, ruajtja dhe filtrimi i të dhënave, ose modifikimin dhe fshirjen e të dhënave.

Mjedisi i SQL përbëhet nga gjashtë lloje të komponenteve siç janë paraqitur në Figurë.

Vini re se që aty ka një SQL agent dhe një implementim SQL, por ka shumë lloje të komponenteve për katalogë dhe faqe (sites).



## Modeli i Sigurisë së SQL

Identifikuesi i autorizimit siguron themelin e sigurisë së bazës së të dhënave. SQL përkrah dy lloje të identifikuesve autorizimit (përdorues) dhe emrat e roleve (rol). Një identifikues përdorues është llogari individuale e sigurisë që mund të përfaqësojë një individ, një aplikacion.

Një emër rol është i definuar si grup i caktuar privilegjeve që mund të caktohet një përdorues ose një rol tjetër. Nëse një emër rol i jepet qasje në një objekt të skemës, atëherë të gjithë identifikuesit përdorues dhe rolet asociohen me rol specifik kanë të njëjtën drejtë qasje ndaj atij objekti kurdo që roli është identifikues i autorizimit aktual.

Emrat e roleve zakonisht përdoren si një mekanizëm për dhënien e një sërë privilegjeve për identifikuesit e autorizimit që duhet të kenë të njëjtat privilegje, të njëjta sikurse punëtorët që punojnë në të njëjtin departament.

Përveç kësaj për identifikuesit përdorues dhe rol, SQL përkrah identifikuesit autorizimit të veçantë me emrin PUBLIC, i cili përfshin të gjithë ata që përdorin bazën e të dhënave.

Padyshim, PUBLIC duhet të përdoret me kujdes të madh, sepse ajo mund të hapë derën për njerëzit me qëllime të këqija.

## SQL shkrehësit (Triggers)

Megjithatë, SQL përkrah objektet që kryejnë veprime automatike, të cilat janë të njohura si shkrehësit (triggers), për t'iu përgjigjur ndryshimeve të bëra nga të dhënat në tabelë. Nëse një modifikim i specifikuar është bërë, shkrehësi thirret apo ngritet automatikisht, duke shkaktuar një veprim shtesë që duhet të ndodh.

Le të marrim një vështrim të shkrehësit në vetvete, siç kam thënë, është një objekt skemë. Këto veprime, të cilat janë të specifikuar në një ose më shumë SQL deklarime, mund të përfshijnë ngjarje si përditësimi (updating) tabelave, fshirjen e të dhënave, duke thirrur procedura.

Shkrehësit thirren apo ngriten kur ju regjistroni të dhëna në një tabelë, ndryshoni ato, ose fshini të dhënat.

Shkrehësit asnjëherë nuk thirren derisa veprimi i caktuar nuk është ndërmarrë. Siq ju mund të konkludoni nga kjo, SQL përkrah tri lloje të shkrehësve: insert; update; delete. Nëse shkrehësi dështon, ngritet një gabim, SQL deklarimi që ka shkaktuar ngritjen e shkrehësit gjithashtu dështon dhe rikthehet në gjendjen fillestare.

## SQL Transaksionet

Transaksioni është një njësi e punës që përbëhet nga një ose më shumë SQL deklarime që kryenë një grup të veprimeve.

ACID është një akronim që përdoret për t'iu referuar katër karakteristikave të transaksioneve:

### Atomic Consistent Isolated Durable.

Nëse ndodhë ndonjë problem në çdo kohë gjatë një transaksioni, i tërë transaksioni kthehet prapa dhe baza e të dhënave kthehet në gjendjen që ishte përpara se transaksioni të fillojë. Nëse transaksioni përfundon me sukses, të gjitha ndryshimet implementohen. SQL përkrah një numër të madhë deklarimeve që lidhen me përpunimin e transaksioneve. Ju mund t'i përdorni këto deklarime për të filluar ose mbaruar transaksionet, me funksione të ndryshme.

## Konkluzion

SQL është një produkt domethënës që ndihmon klientët dhe organizatat të vazhdojnë të ndërtojnë dhe t'iu përkrah në raste kritike, tani me versionet e SQL Server 2012 me më shumë besim dhe efikasitet shumë të lartë. Veglat e reja dhe përmirësimet mundësojnë përparim të rëndësishëm brenda në të gjitha nivelet e organizatës, ndërsa teknologjia cloud ndihmon klientët të qëndrojnë të shkathët për të ardhmen.



Atdhe BUJA MCITP OCA11g CEH  
kandidat për Microsoft Certified  
Master – SQL Server 2008





Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

#### Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

#### Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

#### Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

#### Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

#### Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

#### Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konflikteve
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatieke
- State Protocol

#### Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

#### Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

#### Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

**Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.**



**Kredi për studentë**



**Raiffeisen  
BANK**

*...JETO MË MIRË*

# Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
  - 10,000 Euro deri në 5 vjet
  - 0% - shpenzime administrative

[www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com)  
Raiffeisen Direct: 038 222 222




ANKETA: SA JENI TË KËNAQUR ME KUSHTET QË OFRON UBT-ja?

## TË STUDIOSSH NË UBT ËSHTË NJË MUNDËSI E ARTË



**Xheneta Maloku, studente e vitit të parë në UBT, në drejtimin Menaxhment Biznesi.**

Fakultetin që kam zgjedhur tashmë kam dëgjuar që është me perspektivë të lartë të arsimimit dhe kushtet të cilat ka për studentin janë shumë të mira. Unë jam jashtëzakonisht e kënaqur si studente, për këtë periudhë të shkurt që jam këtu jam duke mësuar gjëra të reja, jam e kënaqur edhe me vlerësim. Në të ardhmen pres të jem ekonomiste e diplomuar si shumë studentë të këtij kolegji.



**Drilon Pllana, student në vitin e parë, në drejtimin Menaxhment Biznesi.**

Unë jam i kënaqur me kushtet që ofrohen këtu, janë të përshtatshme për studime dhe stafi akademik është i shkëlqyer. Semestri i parë përfundoi me sukses për mua, shpresoj të kem sukses edhe në vitet në vazhdim dhe më vonë të shpërblehem me një post të mirë në ndonjë kompani.



**Gazmir Gashi**

UBT sipas mendimit tim është një ndër kolegjet më të mira në Kosovë, për shkak që ofrojnë kushtet më të mira për të studiuar. Gjithashtu, unë si student i shkencave politike kam nderin që kam një staf profesorësh më të mirë që ofrojnë kushte për të mësuar, UBT është një nga më të mirët dhe do i kisha preferuar çdo studenti të studioj sepse nuk do ndahen të zhgënjyer.



**Gëzim Sllamniku**

Unë si student i vitit të parë drejtimi Shkenca Politike jam i kënaqur me ofrimin e kushteve në UBT-, duke filluar prej literaturës që na nevojiten neve studentëve poashtu edhe mësimi praktik e drejtimin tonë është në nivel të duhur.




**Dafina Dibrani, studente e vitit të dytë në UBT, në drejtimin Shkenca Kompjuterike.**

Kushtet janë jashtëzakonisht të mira dhe jam shumë e kënaqur, shpresoj që shumë studentë të ndjekin hapat tonë e të vijnë të marrin sa më shumë dije.



**Erin Godanci**

Mendoj se kushtet të cilat i ofron UBT-ja për drejtimin tim janë në nivel të lartë dhe modern, ndikojnë shumë në zhvillimin e mësimin si nga ana e profesorëve ashtu edhe nga ana e studentëve mund të them se është një ndër kolegjet më të digjitalizuara në rajonin e Kosovës në nivelin e lartë arsimor.



**Blend Humolli**

Në drejtimin e ndërtimtarisë në këtë fushë në UBT ka përparime të shumta në sferën e ndërtimtarisë duke filluar pajisjen me mjetet e nevojshme e deri tek disiplina e mjaftueshme që na dërgon tek suksesi i sigurt, jam i kënaqur shumë me gjithçka që ofron kolegji.



**Fatos Canaj**

Studioj në UBT, drejtimi Inxhinieri të Ndërtimit dhe Infrashtetë në vitin e parë. U përcak-

tova për këtë drejtim meqenëse është drejtim i posaçëm dhe e vetmja e këtij lloji për ndërtimtarin dhe gjerë më tani jemi të kënaqur me kushtet, ligjëratat dhe ushtrimet. Ne jemi gjenerata e parë e këtij drejtimi ku besoj se UBT-ja lirshëm garon me universitetet e tjera vendore dhe ndërkombëtare.



**Edona Tafili**

Jam studente e vitit të parë në Arkitekturë. Kushtet janë super të mira, duke filluar nga Kampusi në Ferizaj, që mos të bëhet tollovi në mësim, ligjëratat janë shumë të kapshme për t'u mësuar duke e bërë bashkë me praktikën, që nëse nuk do të ishte stafi aq i mrekullueshëm nuk do të realizohej praktika e mirëfilltë.



**Blerindona Thaqi**


Jam në vitin e parë, drejtimi i Arkitekturës. UBT-në e shoh si pasqyrë aty ku unë duhet të reflektoj veten. Ndihej falënderuese nga ajo çfarë shfaqin profesorët ndaj nesh, mendoj që suksesi është i pashmangshëm me punën dhe vullnetin që po e shfaqim dita-ditës. Duke marrë parasysh si drejtimin më të kërkuar arkitekturën, këtu në UBT unë dhe të gjithë kolegjet e grupit tonë zotërojmë kushtet e nevojshme për të zhvilluar dhe për të avancuar njohuritë tona në lëmin e kësaj shkence.



**Oktaj Agushi**

Sistemet e informacionit është drejtimi im dhe jam shumë i kënaqur për gjatë viteve të kaluara këtu. Konsideroj se drejtimi për të cilin studioj është tejet atraktiv, derisa edhe mësimi që marrim këtu është shumë i mirë. Jam i kënaqur me tretmanin këtu, pasi vlerësimi i profesorëve gjithnjë është real. Shpresoj që kur të përfundoj studimet, të kem arritur nivelin e dëshiruar në lidhje me drejtimin tim. Ambienti, profesorët, shoqëria e

shumë faktorë tjerë, të shtyjnë të jesh pjesë e suksesit të përbashkët.



**Bardhyl Hyseni**

Vijoj studimet në kolegjin e UBT-së në Prishtinë, edhe pse UBT ka një numër të madh të studentëve, së pari kam nderin që jam student në këtë kolegji. Sai përket kushteve dhe stafit të UBT-së, mendoj që është një ndër kolegjet më të mira në Kosovë. Gjithashtu unë si student i vitit të tretë të Sistemeve të Informacionit më vjen mirë që kam një staf të mirë të ligjëruesve dhe mendoj që ja vlen që studentët t'i përfundojnë studimet në Kolegjin e UBT-së.



**Florian Piraj**

UBT si institucion i arsimit të lartë ofron kushte të mira për studentët e fakultetit të menaxhimit të mekatronikës. Ambientet e ligjëratarave dhe laboratorit janë shumë të sofistikuar, duhet cekur bashkëpunimin ngushtë student-profesor, konsultimi, orientimi dhe trajtimi i problemeve të studentëve është shumë i kënaqshëm. Pasi që mekatronika lidhet shumë me trendet teknologjike nuk mund të themi kurrë se investime janë të bollshme.




**Përparim Salihu**

UBT është vetë fakti se për herë të parë në vend ka sjell programin e studimit për Mekatronikën dhe shtytja ime kryesore ishte që edhe unë dëshiroja të isha pjesë e tij. Universiteti prestigjioz në Kosovë dhe rajon. UBT ka sjellë dhe vazhdon të sjell profesor eminent nga e gjithë bota, dhe këtë unë si student i departamentit të Mekatronikes e vlerësoj shumë.

**Ismajl Shabani**

Në vitin e parë, të drejtimin juridik, jam shumë i kënaqur sa i përket punës që bëjnë stafi akademik.



Shpresoj që këto punë interaktive të vazhdojnë edhe më tutje. Marrëdhënia profesor-student është efektive dhe po ndikon pozitivisht në arritjen e suksesit.



**Vjollca Musliu**

Profesorët janë shumë të mirë, ligjëratat zhvillohen çdo herë në kohë, informimet na vijnë në e-mail për çdo ngjarje, bufeja është në nivelin e duhur, jam shumë e kënaqur me të gjitha kushtet që ofron UBT-ja.

Anketën dhe fotografitë i realizoi:  
**Albina Zeneli**



**TOP EDUCATION  
FOR  
TOP STUDENTS**





# LABOUR MARKETS IN THE ERA OF TECHNOLOGICAL CHANGE: A REVIEW OF OECD JOBS STUDY

There are 35 million unemployed in OECD area. About 33% of young people have no job. Economic growth will play an important role for reducing unemployment but there are some structural problems which need reforming. So some unemployment will be there regardless of cyclical [short-term] developments. This comes because international economy is pressuring for faster adaptation of workers to new technologies, skills and policies. But policies are slowing it down – they are very rigid. OECD countries and government face some trade-offs [economic viability may not secure political support], but they have to move with the requirements of international economy and not succumb to pressure. But governments cannot meet this challenge alone – social consensus needed between governments, labour, trade unions and businesses.



Armend Muja

## 1. An overview of jobs and labour market structure in OECD area

Unemployment rates in Europe have been relatively low between 1950-1975 but it has grown sharply since then – currently 10%, which is higher than in US 7%. The nature of unemployment in EU is persistent meaning that about 40% have been out of work more than a year [structural unemployment], while only 11% in the US face the same problem. The data suggest that EU has been experiencing weaker job creation, stronger growth in productivity in traditional sectors and labour markets function poorly. In the US, there has been growth of jobs [high skilled and low skilled] especially in service sector, lower productivity growth and an increase in wage differential [value of highest paid and worse paid job is so huge]. The movement in numbers of jobs [fluctuations] have been mainly cyclical [short-term] not structural [long-term].

The labour market is strongly influenced by population growth, migration and labour participation. The working-age population in EU is growing more slowly now [0.5%] compared with 1950-70 [1%]. Besides, the working age population is getting older [ageing]. The number of pensioners during 2000-2020 is expected to increase significantly. The labour force is also

affected by international migration. EU absorbed a large number of refugees, asylum seekers and people that moved there due to the fall of communism [East Germany]. Labour participation [percentage of able working-age people that want to work] has remained stable [67%] in the last forty years but remains somewhat lower than in US. The labour market has been absorbing an increasing percentage of women while the percentage of men has been declining.

The percentage of employment in EU – EC has been low [0.3%] compared with higher figures [1.7%] in the US. This small growth came although the percentage of labour force growth decreased [0.5%] compared to double during the 70'. Interestingly, the percentage of people in agriculture has decreased significantly [7%] compared with 14% during 70'. Employment in industry during 70' was higher [40%] compared to 30% during 90'. This points to a change in labour market structure [change in nature of jobs] in favouring of service economy which has increased to 65% compared with 50% during 70'. These developments are influenced by international trade and technology. Imports in EU economy from other countries have been mainly labour-intensive while exports were capital-intensive. There has been an increase in the number of jobs in high-technology industry especially in the UK as the best example but EU remains far from improving its competitiveness in the sector. Further, noticeable changes are also in the increase of part-time and temporary jobs. Most interesting is that growth of jobs in the US was in the private sector while majority [75%] of new jobs created in Europe since 80 have been in the public sector.

One of the main mechanisms that links people and jobs is wage [salary]. Wages

have big impact on employment or unemployment. The determination of how much the wage is going to be is influenced by market itself, legislation and industrial system. They influence the level of real wage [nominal wage per price increases]. The share of wage costs in business increased during the oil shocks of 70' but has stabilized since then. Wage differentials have grown in US but little change in Europe. Low-pay is a high incidence in US – more than EU. The demand for labour in Europe has shifted since 70' from low-skilled to high-skilled labour. But the willingness of workers to accept low-paid jobs is influenced by the generosity of unemployment benefits – benefits tend to be higher in Europe than US and same say that this affects the desire of people to work and people may decide to remain unemployed.

## 2. Causes of unemployment and challenges of labour market

Fears about the causes of unemployment have been unfounded, but they are worth mentioning: (1) technology causes increase in unemployment, (2) imports from low-cost countries cause unemployment – social dumping, (3) intensity of competition coming from international trade to blame [firms getting rid of workers and concentrating on capital technology]. However evidence suggests that they are unfounded arguments. The idea that there is technological unemployment has been long but never evidenced. In fact history shows the contrary – the more technology more jobs. Secondly, the view that imports from low-cost countries have destroyed job-creation potential is weak argument – some jobs might have been lost but more created in high-skill products and exports. Besides, most competition comes from EU countries themselves [70% of trade ends up in EU]. Market

forces push creative destruction [non-performing firms die] and some firms are out but some others are in. Thus, introducing protective policies is bad policy and prevents adaptation to needed change. To slow the intensity of change is not the solution, the solution lies in adapting with change. The adjustment [adaptation] gap and problem has arisen from rigid economies [tight labour market and heavy social policy costs].

The beginning of today's unemployment traces its origin at the end of 60'. Indeed, there was a lot of growth everywhere in OECD and especially in Europe. However, growth started to deteriorate in a turbulent economic environment during 70'. Oil shocks caused much destruction – some estimates that 2% growth potential eroded. But during this period many policies to achieve social objectives were introduced as well – they caused the unintended effect of making labour markets rigid, increasing production costs and making it harder for economies to adapt to new technological requirements. Failure by private sector to create jobs was somehow compensated by an increasing number in public jobs. Incentives to accept low-paid work had already disappeared due to minimum wage. US labour market was more flexible and had less social costs and therefore performed better. Many jobs it created were low-paid but many would have been worse off without them. But bad jobs in US and no jobs in EU came from the same root cause – failure to adapt to change that international economy required: better education and skills, more training, no legislative obstructions to labour market. The solution to this is to remove that obstacles that were created due to measures which were intended at meeting social objectives – question remains how to ensure labour flexibility without harming social programmes and welfare.

An economy's ability to create jobs depends partly on macroeconomic environment [sound public finance, low inflation, aggregate demand – growth that is not too rapid not to slow]. An economy's growth depends on investment [which requires savings]. But this has declined in OECD in recent years. A stable economic environment depends on price stability – no distortion in price signals. Furthermore, cutting budget deficit would increase confidence in economy and would release private investment [absorbed by public investment]. Macroeconomic stability works well for growth if followed by structural reforms – that is removing economic rigidity and social distortions and allow economy to allocate resources to most efficient use.

## 3. Future steps and policy approaches

Having analysed some of the problems, it is worth mentioning some suggested policies and steps to move ahead. Policy recommendations are to help with enhancing the ability to change and increasing the capacity to innovate and be creative. Most countries face similar problems and needs. The way ahead lies in the following measures: set macroeconomic policy such that encourages growth – coupled with structural reforms and removal of rigidities, enhance the creation and diffusion of technology, increase flexibility of working time and nurture an entrepreneurial climate. Furthermore, wages and labour markets should be more flexible and restrictions that prevent wages from reflecting market conditions should be removed, reform unemployment programs so as to push those able back to work, strengthen emphasis on active labour market and their effectiveness, improve skills and productivity through improvements in education system.



# LIGJËRATË E ALBIN KURTIT NË UBT

PRISHTINË, 28 MARS 2014

Albin Kurti, Kryetari i Komisionit për politikë të jashtme në Kuvendin e Republikës së Kosovës, para studentëve të UBT-së mbajti një ligjëratë me temën "Sa është i (pa)varur është shteti i Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare".

Gjatë prezantimit të tij, Kurti foli për varësinë legale dhe juridike të shtetit të pavarur të Kosovës nga faktorët ndërkombëtar. "Nuk ekzistojnë vetëm dy mënyra të marrëdhënies me faktorët ndërkombëtar: nënshtrimi servil dhe armiqësia e plotë. Me faktorët ndërkombëtar duhet ndërtuar marrëdhënie

partneriteti dhe aleancash përtej këtyre dy ekstremeve," theksoi Albini.

Z. Kurti në këtë ligjëratë renditi pesë çështjet problematike të këtyre misionëve ndërkombëtare në Kosovën e pasluftës. "Së pari, - tha ai, - mosnjohja dhe mospranimi që ata ia bënë shtetit të Kosovës dhe pavarësisë së vendit tonë, së dyti, fuqitë e tyre ekzekutive të pakufizuara në kohë dhe në gamën e tyre, së treti imuniteti nga ndjekja penale e gjithë personelit ndërkombëtar bashkë me familjet e tyre, së katërti, mungesa e llogaridhënies ndaj institucioneve vendëse, së pesti, paradigma e stabilitetit

afatshkurtër politik që sakrifikon demokracinë, drejtësinë dhe zhvillimin."

Në përfundim Albin Kurti solli në vëmendje faktin se politika e jashtme e Kosovës është e domosdoshme të marrë një kah tjetër, atë të këmbëngulësisë për interesat e Kosovës dhe të bashkëpunimit bilateral në funksion të këtyre interesave. Por këtë mund ta realizojë veç një brez i ri, me mendim të qartë dhe dije e përkushtim adekuat.

Pas ligjëratës, vazhdoi diskutimi me pyetjet dhe komentet e shumta të studentëve të pranishëm.



# ZËVENDËSKRYEMINISTRI PACOLLI U SHPJEGOI STUDENTËVE TË UBT-së IDENË E ZONA VE TË LIRA EKONOMIKE



PRISHTINË 4 PRILL 2014

Krijimi i zonave ekonomike ka arsyeshmëri ekonomike, pasi ato mund të ndikojnë në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe në rritjen e mirëqenies së banorëve tha zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli para studentëve të UBT-së. Kjo ide e iniciuar që nga viti 2007 dhe e paraqitur në programin politik të AKR-së. Duke folur për Mitrovicën, Pacolli tha se dialogu është i domosdoshëm për zgjidhjen e problemit të veriut, por qenësore sipas tij është përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.

"Ajo që do të jetë kruciale për rregullimin e problemit politik të veriut është vetëm mirëqenia

ekonomike. Nëse unë ndërtoj një fabrikë dhe hapi rreth 1 mijë vende pune, ju do të shihni se ato barrkada që janë do të eliminohen vetvetiu dhe njerëzit do të qohen në mëngjes dhe do të vijnë të punojnë dhe anasjelltas", tha Pacolli.

Z. Pacolli shfaqti besim se ideja e tij është në dobi të bashkimit të Mitrovicës, dhe theksoi se nëse qytetarët e mbështesin, këtë ide do ta realizojë me bashkëpunëtorët e tij.

"Dhe do të shihni se nuk ka nevojë asnjë plumb me e harxhu, nuk ka nevojë asnjë viktimë me e humbë, nuk ka nevojë me u nervozu dhe vetvetiu ky problem do të jetë i zgjidhur", theksoi ai.

Ndërkohë në Gjakovë sipas tij ekziston infrastruktura, respektivisht fabrikat që janë të bllokuara, dhe që mund të përdoren.

Përparesi tjetër është se në këto zona ekonomike mund të vijnë investitorë të shumtë, të cilët do të aktivizojnë fuqinë punëtore që sipas tij është proaktive dhe njëkohësisht do të bëhet ndërkombëtarizimi i Kosovës pasi shumë produkte do të prodhohen në Kosovë dhe do të eksportohen jashtë vendit.

Në këtë ligjëratë Pacolli foli edhe për krijimin e tregut të përbashkët me Shqipërinë por edhe çështje tjera.

# MINISTRJA VLORA ÇITAKU DEBAT NË UBT

PRISHTINË, 8 PRILL 2014

Ministrja e Integritimit Evropian, Vlora Çitaku, ka mbajtur një ligjëratë para studentëve të UBT-së me temë "Rruga drejtë Evropës", por me theks të veçantë Çitaku u është referuar temave: "Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit", si dhe "Procesi i Liberalizimit të Vizave".

Çitaku tha se Republika e Kosovës është ballafaquar me shumë sfida, që prej daljes nga lufta për liri, dhe duke u ngritur në një demokraci funksionale, me institucione të qëndrueshme dhe ekonomi të lirë të tregut, ku liria e fjalës, fesë, dhe të drejtat e tjera themelore janë të garantuara. "Sot ne jemi para në një epokë të re, të epokë të integritimit evropian. Kosova fuqimisht beson që evropianizimi është mënyra më e mirë për të ecur përpara në përmirësimin e standardit të jetës dhe për ta nxitur zhvillimin ekonomik për të gjithë qytetarët.

Kosova është në përfundim të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA). MSA-ja do ta ankorojë Kosovën fuqimisht në rrugën e saj drejt



anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe njëkohësisht do të shënojë një momentum historik në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së", ka thënë ministrja Çitaku.

Kurse për procesin e evropianizimit, Çitaku ka deklaruar se,

është më shumë se vetëm miratimi i legjislacionit të BE-së dhe përmbushjes së normave dhe standardeve të BE-së. "Qeveria ka shprehur vazhdimisht përkushtimin e saj për agjendën evropiane me vepra, po aq sa edhe me fjalë. Bërthama e

përkushtimit tonë qëndron në mbështetjen e madhe të qytetarëve tanë, për ndryshimet që do ta transformojnë vendin tonë në një anëtar krenar të familjes evropiane. Në tetor të vitit 2012, Studimi i Fizibilitetit konfirmoi se Kosova është kryesisht e gatshme për t'i filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit. Pra me këtë është konfirmuar që Kosova ka një perspektivë të qartë drejt anëtarësimit në BE, në linjë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor", ka theksuar ministrja Çitaku, duke shtuar se "nisja e negociatave për Marrëveshjen Stabilizimit Asociimi në mes të vendit tonë dhe Bashkimit Evropian, është një moment historik në kuadër të procesit integruar të vendit tonë, për ç'arsye më 27 shkurt, Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar ekipin negociator".

Po ashtu ministrja Çitaku, ka folur edhe për procesin negociator që nga fillimi i punës e deri më sot. "Stabilizim-Asociimi do të jetë marrëveshja e parë kontraktuale në kuadër të së cilës Republika e Koso-

vës dhe Bashkimi Evropian do të bëjnë zotime të ndërsjella: nga njëra anë, vendi ynë për të ndërmarrë reforma edhe më të thella dhe nga ana tjetër BE-ja do të ofrojë mundësi reale për anëtarësim.

Shtetndërtimi i Kosovës është proces i pakthyeshmë dhe Kosova është në vazhdimësi duke u konsoliduar si shteti më i ri evropian. Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka shënuar progres të jashtëzakonshëm qoftë në kuptimin e njohjeve, qoftë në kuptimin e anëtarësimit në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, e cila ka forcuar pozitën e shtetit tonë në skenën e jashtme", ka deklaruar ajo.

Kurse për liberalizimi i vizave, Çitaku ka bërë me dije se institucionet e vendit janë të angazhuara t'i zbatojnë kriteret dhe rekomandimet e Komisionit Evropian.

Të pranishmit nga stafi akademik dhe studentët patën mundësi që ministres Çitaku, t'i drejtojnë pyetje në çështje kryesive politike që kanë të bëjnë me rrugëtimin e vendit tonë drejt Evropës.



## REPORTAZH



# VETMIA

**Dashuria nuk zhduket edhe kur nuk duket. Ngushëllohem me faktin që fatet e tyre, nënë e bir, janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe herët a vonë djalin e saj do ta brejë ndërgjegjja, do të kthehet dhe do të qëndrojë me nënën e tij, sepse njeriu nuk mund ta ndajë çka bashkon ZOTI!**

Erërat e forta në mbrëmjen e së dielës trokitën në çdo dritare. E vetmja që e ndjente këtë ftohësi që e prekte në shpirt ishte një plakë 70 vjeçare, emri i së cilës është Fatmire Mujaj, por e njohur si Nushe, që qëndronte në prag të derës duke pritur që t'i vinte dikush në ndihmë.

Ajo ka pasur një djalë, por fatkeqësisht ai e ka humbur jetën në një aksident. Ka edhe një djalë që jeton në Itali dhe vjen rrallë ta vizitojë. Ajo ka shumë mall për burrin e saj. Edhe aie ka humbur jetën para pesëvitesh...

Kujtt' i them sa më mungon?! Askujt nuk do t'ia them! Vetëm ai e di! Ti je larg, por unë të kam me vete, ndoshta se kupton. Bashkë me ty po e kaloj jetën, edhe pse ti MUNGON, edhe diell të bëhesh të gjithë nuk i ngroh dot, prandaj mua më mungon një pjesë e shpirtit tim, fëmijët e mi kanë pasur nevojë për një baba, siç ishte ai për t'ju bërë hero i parë i jetës së tyre dhe shtylla mbështetëse.

Gjithmonë kam jetuar me frikën se mos humbas diçka shumë të veçantë dhe e kam humbur, por

kam mbijetuar dhe jetoj akoma. Psenuk vjen djali im të më thotë: "Nënë, ti je vet bukuria që të shoh brenda një loti, ti je dritë që rrezaton, se me dritë të krijoi Zoti, nga gjiri yt i shenjtë lindi një jetë, gjithë të mirat e kësaj bote do t'i gjej te zemra jote".

Duart e saj të vrazhda tregonin që jeta e saj nuk ishte aspak e lehtë. Ajo e urren vetminë. Qenia njerëzore mund të përballojë një javë pa ujë, dy javë pa ushqim, e vite e vite të tëra pa strehë, por jo vetminë. Ajo është më e keqja e të gjithave torturave, më e keqja e të gjithave vuajtjeve. Thotëse vetmia është e këndshme kur e zgjedhim vet, mirëpo e egër kur detyrohem ta jetojmë.

Mbretëronte pa mbretëri, perëndonte pa perëndim, perëndeshë e fantazisë, të ma kthejnë shpinën nuk patën një motiv, bëj një hap ndalem prapë se dhe unë në shpirt kam gjak, pa ty o djali im nuk ka kuptim, je gjithçka për shpirtin tim, unë po vazhdoj jetën që e le, jam e vvarë njësoj si ti, veç një hije jam që frymë merr. Kur s'e ke një motiv, me zinxhir jo mos më

lidh, pyet zemrën e njeriut a ka ndjenja?... Sie përballon vetminë duke u ndier e thyer pyet zemrën ti se vetëm ajo di, sa të gjata janë netët kur dhembjet nuk janë shëruar dhe ndjehesh si e mallkuar dhe dita e ditës po kuptoj që po jetoj një jetë që nuk duket më si e imja. Sa vështirë është ta lutësh dikë që nuk ka mëshirë, ta duash dikë që nuk njeh dashuri, të durosh kur nuk mundesh, të bëhesh e verbër kur të gjitha i shikon, të qeshesh kur shpirti të loton, të luftosh atëherë kur je e dorëzuar, dhe në fund ta marrësh çmimin e pa merituar – Vetminë. Por, ç'të bëj? Engjëjt nuk jetojnë në tokë, shtëpia e tyre është qielli.

Nushja nuk dëshiron që të tjerët ta dinë që ajo e vuan vetminë dhe nuk pajtohet me të. "Çdo njeri fsheh pas vetes një histori, ka një arsye pse ata janë ata që janë, ata nuk janë kështu se duan, diçka në të kaluarën i ka bërë të tillë dhe shpesh e pamundur të ndryshojnë", shprehet Nushja me lot në sy. "Çdo gjë në botë është ekzistuese por jo e gëzueshme, por asgjë nuk zgjat përgjithmonë, është një më-

sim i lehtë që e kemi mësuar mjaft vështirë".

Një psikolog nga Vitia, Nexhbedin Avdyli tregon më shumë rreth vetmisë si fenomen që në aspektin psikologjik edhe në një mjedis shokësh dhe miqsh mund të ndihesh i vetmuar. Ndërkohë që edhe larg njerëzve mund të mos ndihesh i tillë. "Të ndihesh i vetmuar do të thotë të ndihesh i përjashtuar nga grupi, i papëlqyeshëm prej njerëzve që të rrethojnë, i paafte për të ndarë vlerat e tua personale, ose i ndryshëm dhe i huaj prej atyre që ke pranë", u shpreh psikologu Avdyli.

Të vetmuarit e kanë tepër vështirë të prezantojnë veten para të tjerëve, të bëjnë telefonata dhe të marrin pjesë në grupe. Këta persona të vetmuar shumicën e gjërave i shikojnë jashtë kontrollit të tyre dhe të tjerët i perceptojnë në mënyrë negative dhe shikimi negativ i gjërave i shtyn të vetmuarit të përfshihen në sjellje negativiste. Këta persona kur shoqërohen me një të huaj të së njëjtës gjini, apo me një shok dhome, studentët e vetmuar kanë predispozicionin ta perceptojnë negativisht personin tjetër.

"Me një fjalë kuptohet se vetmia është ndjesi e dhimbshme", thotë Nexhbedini.

\*\*\*

Ajo u gëzua që po bie shi e të mos qante vetëm. Thoshte: "Jeta u tregua e padrejtë me mua duke ma marrë burrin në moshë të re". Shtëpia ku qëndronte ajo ishte shumë e parregullt, sikur të ishte një derë që nuk ka dalje dhe e gjitha çfarë ajo plakë pëshpëriste: "Dua të jetoj një jetë si të tjerët; pse m'u shuan ëndrrat si një kandil që nuk bën dritë, pse ëndrra për të pasur afër njerëzit i dua u hodh në humnerë, thjeshtë... Pse ekzistoj"... Unë më pas ia vura dorën në sup duke u munduar ta ngushëlloj, ta mbështes, por prapë kot së koti gjërat shiheshin vetë... dyshmeja e lagur, orenditë e vjetra, ushqimi i paktë ose pothuajse asgjë.

Ajo mendoi se ka ardhur koha t'i flakte të gjitha gjërat e imagjinuara, të fillojë ta mendojë realitetin e hidhur por ajo nuk do që të gjitha ato ëndrra për të pasur një pleqëri të mrekullueshme të shkojnë në humnerë ajo do që çdo cikël ëndërror të shfaqet si një refren i përsëritur brenda një kënge motivimi dhe vullneti. Unë u mundova që me fjalë të buta ta qetësoja duke i thënë që askush nuk është perfekt gjëra të tilla ndodhin por duhet të jetë e fortë dhe ti përballojë pa marrë parasysh sa të rënda janë. Ajo më shikoi me një shikim shumë shpresëdhënës duke më thënë: "Ti je e re dhe nuk e di ndjenjën e nënës për fëmijën e vet dhe duhet t'i thuash ëndrrës vazhdo të ecësh përpara dhe mos u ndalo. E di??? Një vajzë bën përpjekje titanike për të vazhduar përpara dhe nuk do që të jetë vetëm një iluzion jetëshkurtër që të zhduket si një rrufe në qiell të hapur"! Jeta është e vlefshme dhe kjo moshë e imja të mëson

se jeta është nënë, është babë, është diell, është hënë, me të dikë e do, me të ndjenja krijon, me të njeriun e disponon por për të njeriu ulet dhe qan.

Në atë çast më shkoi ndër mend se si është një nënë, një magjistare e cila të zhduk çdo dhembje dhe vuajtje vetëm me një puthje, është një diell që nuk perëndon, një nënë që rrugën ta ndriçon. Po të ishte nëna pa fëmijë do të ishte si peshku pa ujë, nata pa hënë apo thjeshtë si një njeri i vetmuar. Nushja me lot në sy më tha: "Në këtë dhome, që në vitet e kaluara ishte e mbushur me gëzim e harmoni, tani është e tëra në të zi, atëherë të gjithë ishim bashkë aty, aroma e harmonisë vinte në çdo vend, veç kush mbeti vet, ah... veç ai e kupton dhimbjen time dhe trishtimin tim. Çdo ditë e më shumë e ndjej aromën e më të dashurve. Nga djemtë e mi shpresova të më thoshin lamtumirë por më kot shpresova sepse shpresa vdes e fundit për çdo njeri".

Unë tani këto fjalë po i them për jetën, sepse ajo është sikur një përrallë e shkurtër që në fund mbaron me ndarje dhe trishtime. Kjo jetë është si një fjalim i cili të jep ide por në fund trishtimi i madh e pret secilin njeri! Unë duke shkuar i thashë që të mos trishtohej dhe ajo ma ledhatoi faqen më përqafoi e më tha: "Këto fjalë që t'i thashë mbaj mend gjithmonë". Duke ecur rrugës për në shtëpi shkova me trishtim sikur duke u tretur dhe duke menduar gjithçka deri në shtëpi. Kur mbërrita ia tregova nënës të gjitha dhe ajo më tha: "Është e fundit LAMTUMIRA. Syri i Zotit dhe zemra e nënës të ndjekin kudo"! E mbyll me këtë fjalë që bart porosi që mos të lëndojmë aty ku dhemb, sepse zemra e nënës është shumë e brishtë dhe gjithmonë ekziston dikush që është i zënë duke u munduar ta shkatërroj gjininë më të bukur që Zoti ka krijuar për të na bekuar të gjithëve. Tëqenit femër është ndjenjë dhe jo gjendje fizike, ato me shumë kujdes e udhëheqim botën e fshehtë të ëndrrave. Ahhh, sikur njerëzia të ishte Nënë, bota nuk do të ndiente dhimbje. Nëna është diell që nuk perëndon. Nëna është gëzim që jetën ta zbukuron. Nëna është yll që natën të ndriçon. Nëna është thesari më i çmuar që në këtë botë posedon. Kur rashë të fle po mendoja, me lot në sy: O Zot, si mundet që dikush t'i bëj keq asaj, pse ajo të jetë aq e trishtuar kur i meriton të gjitha të mirat. Pse të jetojë ajo vetëm me përralla. Përmua ajo ishte thjeshtë një KRYEVEPËR.

Dashuria nuk zhduket edhe kur nuk duket. Ngushëllohem me faktin që fatet e tyre, nënë e bir, janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe herët a vonë djalin e saj do ta brejë ndërgjegjja, do të kthehet dhe do të qëndrojë me nënën e tij, sepse njeriu nuk mund ta ndajë çka bashkon ZOTI!

Realizuan: Albina Zeneli dhe Besart Troshupa



INTERVISTË ME NITA LATIFIN

# NITA: TEKSTIN E KËNGËS E REALIZOI AIDA BARAKU

Ajo është një interpretuese shumë e mirë e muzikës live, ka përfunduar gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Është pjesë e një bendi muzikor me të cilin performon live. I pëlqen shumë aktrimi



"Unë nuk besoj në rivalitet kur është në pyetje arti", thotë këngëtarja Nita Latifi për gazetën UBT News në një intervistë realizuar përmes rrjetit social Facebook.

**UBT News: Na tregoni diçka për veten.**

**Nita Latifi:** Unë jam Nita nga Prishtina, 21 vjeçe, merrem me muzikë dhe studioj gjuhën angleze.

**UBT News: Si lindi ideja e serialit "Andrrat"?**

**Nita Latifi:** E pashë audicionin, shkova të provoj dhe mora një rol shumë të mirë.

**UBT News: A ishit e kënaqur me rolin tuaj?**

**Nita Latifi:** Isha shumë e kënaqur, jo vetëm me rolin por edhe me bashkëpunimin me artistat dhe regjisorët, kemi kaluar kohë shumë të mire bashkë.

**UBT News: Kush e realizoi këngën pjesëmarrëse në TOP FEST 11?**

**Nita Latifi:** Këngën e ka realizuar kompozitori Enis Mullaj dhe tekstin Aida Baraku.

**UBT News: A jeni e kënaqur me suksesin e kësaj kënge?**

**Nita Latifi:** Jam shumë e kënaqur me suksesin e këngës, është pëlqyer shumë edhe në Kosovë edhe në Shqipëri, kam marrë shumë mesazhe dhe komente të bukura që më kanë bërë të ndihem mirë.

**UBT News: Pse vendosët të riktheheshit në skenë pikërisht në festivale?**

**Nita Latifi:** Pasi që pushova, njëkohësisht u morra me studimet, nuk e kisha në plan të bëj baladë po si gjithmonë gjërat spontane janë më të bukurat, ndërrova mendje posa e dëgjova. Vendosa të shkoj në Top Fest prapë se eksperiencia e kaluar ka qenë shumë e mirë dhe të kënduarit live më bën të ndihem më rehat në skenë.

**UBT News: A ka të bëjë teksti i këngës "Histori" me jetën tuaj private?**

**Nita Latifi:** Unë shkruaj tekste edhe vet, por me qenë se për baladë nuk kisha ide assesi nuk po frymëzohesha nga jeta e përditshme, ja besova tekstshkrueses së madhe Aida Barakut, kështu që nuk ka të bëjë me jetën time private se po të kishte do ta shkruaja vet.

**UBT News: A keni përkrahje nga kolegët?**

**Nita Latifi:** Normalisht, tash kemi kaluar kohë në skenë dhe me shumicën njihemi, e përkrahim njëri-tjetrin pasi që shteti nuk na përkrah. Hahaha...

**UBT News: Kë e konsideroni rival të skenës?**

**Nita Latifi:** Rival? Unë nuk besoj në rivalitet kur është në pyetje arti, detyra e artistit është që të jetë i veçantë në atë që bën, kështu që nuk mund të krahasohet njëri me tjetrin e të quhemi artista.

**UBT News: Na shpalosni planet tuaja?**

**Nita Latifi:** Mi shpalosë?! Oh veç sa i palovahahaha!! Projekti tjetër ka filluar por nuk do të bëj publike asgjë para se të mbaroj Top Festi. Pastaj të shohim, ndoshta me një videoklip...

Intervistoi:  
Albina Zeneli

BISEDË ME Z. ARBEN BIBA, PERSONAZHI KRYESOR I TELENOVELËS "STINË DASHURIE"

## BIBA: PROJEKTI DO TË SHKOJË DERI NË FUND ME MUA

**UBT News: Na trego pak për origjinën dhe shkollimin tuaj?**

**Biba:** Quhem Arben Biba. I lindur në rrethinën e Ferizajt, e i rritur në Basel të Zvicrës. Kam përfunduar një vit shkollim për vallëzim, aktrim e këndim në shkollën "Performing Arts" dhe tre vite në shkollë të aktrimit në Gjermani.

**UBT News: Deri më sot, në sa filma të zhanreve dokumentar, telenovela, drama, etj., keni marrë pjesë?**

**Biba:** Kam pasur shansin të luaj disa role në teatro të ndryshme në Gjermani e Zvicër. Poashtu edhe para kamerës në disa projekte të filmave të shkurtër, dokumentarë, filma me metrazh të gjatë dhe dy role të vogla në telenovela gjermane.

**UBT News: Si keni arritur të bëheni personazhi kryesor i telenovelës "Stinë dashurie"?**

**Biba:** Kohë më parë kam filluar një dokumentar me temën për religjionet në Kosovë, mirëpo projekti u ndërpre për shkak se gjërat nuk rrodhën ashtu siç ne menduam. Ky ishte projekti i parë në Kosovë.

Gazetarja Mirjeta Baraliu më ftoi në RTK si mysafir në emisionin "Teleokino" dhe me ndihmën e saj u rregullua kontakti me Lulzim Gjuhëllin dhe Trim Musliun (producentët). Me këta dy të fundit biseduam për projektin në serialin "Andrat" dhe puna ime e pëlqyer rezultoi që unë të fitoj rolin kryesor në "Stinë Dashurie".



**UBT News: Ka zëra nga publiku se për një kohë të shkurtër mendoni të braktisni serialin, a qëndron kjo?**

**Biba:** Jo nuk është e vërtetë. Shpresoj se projekti do të shkojë deri në fund me mua. Momentalisht janë duke u xhiruar 36 episode për sezonin e parë, mirëpo edhe për sezonin e dytë jam i paraparë të luaj edhe 36 episodet e tjera.

**UBT News: Si do të përfundojë personazhi kryesor i këtij seriali, duke qeshur apo diku në humnerë?**

**Biba:** Shpresoj se do të përfundoj i lumtur. Edhe pse kjo gjë është në dorë të skenaristëve.

**UBT News: Mund të na flisni për ndjenjat gjatë luajtjes së një personazhi pozitiv dhe ato kur personazhi është negativ?**

**Biba:** Si unë, ashtu edhe personazhi do të kemi probleme për

t'i kuptuar disa gjëra në Kosovë. Mirëpo, si unë, si ai do të mundohemi të mësohemi me sjelljet këtu. Kështuqë shpresoj se nuk do të shohim shumë anë negative nga Albani, do të jetë zemërmirë dhe i dashuruar.

**UBT News: Gjatë telenovelës kemi parë se bëni xhirime në territorin e Kosovës. Në sedikush ju ofron të bëni 10 skenarë filmi për këtë vend, cila do të ishte tema kryesore e filmave tuaj?**

**Biba:** Do të bëja një film për Skënderbeun apo për Ballistët.

**UBT News: Tërë kohën flisni vetëm në gjuhën angleze, gjermane dhe frënge. Si qëndroni me gjuhën shqipe, atë po e flisni në serial?**

**Biba:** Është e vërtetë se me gjuhën angleze dhe gjermane ndihem më lehtë. Por gjuhën e parë të cilën e kam mësuar është

shqipja, kështuqë me kohë po e ndjej veten më të sigurt në gjuhën time amtare. Poashtu edhe kolegët më ndihmojnë dhe deri më sot nuk kam pasur ndonjë vështirësi në serial.

**UBT News: Gjatë tërë kohës ju rritni me shokun tuaj, Blerim Qeriqin? Po të dashurën ku e keni?**

**Biba:** Beni është një kolegi i ekipit ekzekutiv i serialit dhe jemi në moshë të njëjtë. Të dy kemi jetuar në diasporë dhe vështirësitë që i përjetojmë me jetesën në Kosovë i ndajmë së bashku. Kurse të dashurën duhet ta gjej së pari. Hahaha..

Intervistoi: Alba Merovci  
dhe Xhejlane Sopa

## VIGANI : "THE LOVERS"

Tashmë i njohur si vokalist dhe bass kitarist i Rock-bend-it "THE LOVERS", Vigan na rrëfen se me muzikë ka filluar të merret qysh nga moshë 10 vjeçare. Fillimisht mësoi disa nota në kitarë dhe melodi të lehta. Mirëpo, punën intensive për vokal dhe kitarë e ka filluar në moshën 16 vjeçare.

Vigani thotë se falë njohjes me disa shokë të cilët kishin poashtu të njëjtën shije muzikore, ata formuan një bend me 5 anëtarë. E ai bend tani quhet "The Lovers".

Grupi "The Lovers" është një bend i formuar në maj të vitit 2013. Ajo se çfarë bën të zgjoj kureshtjen për këtë grup është lloji i muzikës që ata bëjnë. Kureshtje prek edhe emri i grupit, i cili ka për qëllim ta lirojë dashurinë mes njerëzve në të njëjtën mënyrë si dielli kur lëshon dritë bashkë me reze në tokë.

Iliaz Luzha



## University of Warsaw



### Bachelor and Master Degree in International Relations

Apply for Scholarship!

#### Teaching and Research Areas

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



#### University of Warsaw (UW)

Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

#### UW Highlights:

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

#### Institute of International Relations:

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

#### Fees & Financing:

Bachelor: 1300 € / Year  
Master: 2000 € / Year

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Come to UBT and get European degree

#### TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: warsaw@ubt-uni.net  
Email: ismn@uw.edu.pl  
Institute of Warsaw  
www.ism.uw.edu.pl

## Danube University KREMS



### Master of Business Administration - MBA

#### Specializations with MBA Program

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management

Apply for Scholarship!

#### Fees & Financing

Tuition fee: Euro 21,900

Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

#### Danube University



Danube University KREMS has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University KREMS combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

#### Department for Management and Business

We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

#### Top 10 Reasons to Join a Danube MBA

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni

Top University Education for Top Students!

#### TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: dukmba@ubt-uni.net  
Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at  
Tel: +43 (0)2732 893 2126  
Web: www.donau-uni.ac.at

## Vienna University of Technology



CONTINUING EDUCATION CENTER



### Msc Engineering Management Your key to the top engineering league



#### CONTENTS

Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

#### MODALITIES

3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

#### PROGRAM START

January 23, 2014

#### APPLICATION DEADLINE

November 15, 2013

#### INFORMATION SESSION

October 4, 2013

Apply for Scholarship!

#### FEES & FINANCING

Tuition fee: Euro 22,000

Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000

The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

#### HIGHLIGHTS

- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



Top University Education for Top Students!

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

Vienna University of Technology  
Continuing Education Center  
Operngasse 11 • A-1040 Vienna  
T +43(0)1/58801-41701 • engineering@tuwien.ac.at  
Email: engineering@ubt-uni.net  
http://engineering.tuwien.ac.at





# Top University Education for Top Students



- 13 vite Lider i Arsimit të Lartë
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001 për cilësi
- Përfitues nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Inovacione

*Zgjedh më të mirin ...*

*... që të bëhesh më i miri!*

*Come to UBT and Go International...*

## PROGRAMET E AKREDITUARA

- **MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)**
  - Financa, Banka dhe Kontabilitet
  - Marketing dhe Shitje
  - Manaxhment dhe Ndërmarrësi
- **SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)**
  - Rrjeta dhe Telekomunikacion
  - Softuer dhe Sisteme Inxhinierie
  - Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
  - Dizajn dhe Multimedia
  - Mekatronikë dhe Robotikë
- **MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (Baçelor dhe Master)**

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial Ndërmarrësi dhe Menaxhment)
- **SISTEMET E INFORMACIONIT (Baçelor)**

(Menaxhment, Biznes dhe Informatikë)
- **ARKITEKTURË (Baçelor)**

(I vetmi privat i akredituar në vend)
- **INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor)**

(I vetmi privat i akredituar në vend)
- **SHKENCA POLITIKE (Baçelor)**
  - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
  - Integritime Evropiane
  - Administratë Publike
- **JURIDIK (LLB)**







(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)
- **MEDIA DHE KOMUNIKIM (Baçelor)**

## PROGRAMET NË PROCES TË AKREDITIMIT

- **SISTEMET E INFORMACIONIT (Master)**
- **POLITKA PUBLIKE DHE MENAXHIM (Master)**
- **JURIDIK (LLM)**
- **INFERMIERI (Baçelor)**
- **ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR (Master)**
- **STUDIMET E DOKTORATËS NË:**
  - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi
  - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri
  - Menaxhim i Mekatronikës

## STUDIME DHE BURSA NË UNIVERSITETET PARTNERE

Përmes UBT-së ju mund të studioni dhe të përfitoni bursa studimi në Universitetet partnere si:

-  Vienna University of Technology, Austri  
Engineering Management (MSc)
-  University of Warsaw, Poloni  
International Relation (BA, MA)
-  City University London, Angli  
Computer Science and Engineering (BSc, MSc)
-  HiG - Gjøvik University, Norvegji  
Computer Science and Engineering (Mobility)
-  CIFE - Centre International de Formation Europ, Francë  
European Integration and Law (MA)
-  Danube University Krems, Austri  
Master in Business Administration (MBA)



WIT (Waterford Institute of Technology), Irlandë  
Master in Information Systems (MSc)

Universita' degli Studi di Napoli Federico II, Itali  
Business Administration (BSc)

## Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

**Gjuha e studimeve:** Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

## Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta dhe me korespondencë. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

## Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.

## Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është **1200 €**, me mundësi pagese deri në **12 këste**.
- Për të gjithë **nxënësit e dalluar** UBT ofron zbritje 20-50%

## UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30  
Aploko online: [www.ubt-uni.net/aploko](http://www.ubt-uni.net/aploko) ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Gjilan, Prizren, dhe Gjakovë